

Language L.24


# Albanian



مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

لتعريف بالإسلام

Version Date: September 2022



Part of the







Learn more about Islam with our informative and educational materials, translated to over 50+ languages

@islamicdxb



# CONTENTS



# RRETH ISLAMIT

ALBANIAN

(01/08)

نبذة عن الإسلام

FREE COPY

## Prezantim i shkurtër i Fesë Islame



Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

للتنوير بالاسلام

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري | تصريح رقم: (2017/139) | Islamic Affairs & Charitable Activities Department

www.islamicic.com

# RRETH ISLAMIT

Islami është mënyrë të jetuari gjithëpërfshirëse dhe e kompletuar, e nxit njeriun që të përmirësoj lidhjet e tij me Allahun dhe marrëdhëniet me njerëzit. Mësimet e Islamit tregojnë se njerëzit nuk gjejnë lumturi të vërtetë dhe paqe të përhershme veçse duke njohur Allahun, duke ndjekur udhëzimet e Tij dhe duke bërë vepra të mira të cilat i sjellin dobi individit si dhe rrethit shoqëror ku ai jeton.

Muslimanët përbëjnë përafërsisht një të pestën e popullsisë së botës, duke bërë që Islami të jetë një nga fetë me më shumë pasues.

*Prej veçorive që dallojnë Islamit nga fetë e tjera është se Islami nuk e ka zanafillën te një fis apo individ i caktuar.*

Besimi te Allahu dhe veçimi i Tij në adhurim është qëllimi parësor i jetës, dhe themeli mbi të cilin ngrihen shtyllat e Islamit.

Fjala "Islam" në gjuhën arabe do të thotë nënshtrim ndaj Allahut dhe dorëzim te Ai.

Ai i cili vullentarisht i nënshtrohet Allahut quhet musliman, pa marrë parasysh racën, ngjyrën apo kombësinë që posedon.

Allah është emri i përveçëm i Zotit të Vetëm që meriton të adhurohet.

## GJASHTË SHTYLLAT E BESIMIT

### 1. Besimi te Allahu i Lartësuar

"Allah" në gjuhën arabe është emër njëjës i veçantë që nuk përdoret për askë tjetër veç Zotit të Vërtetë e të Vetëm.

Allahu nuk ka kundërshtarë, ortakë, të barabartë, prindër apo fëmijë. Asgjë nuk është si Ai, Ai është Dëgjuesi, Shikuesi. Atij i përkasin atributet më të larta dhe emrat më të bukur. Ai është i Lartësuari, Fuqiploti, i Drejti, i Urti, i Gjithëdijshmi.

Ai është Krijuesi dhe Furnizuesi i çdo gjëje, Ai i cili na ka dhënë mirësi të panumërta si dëgjimi, shikimi, të menduarit, të folurit, aftësia e të ecurit .. etj. Prandaj, ne duhet të falendërojmë dhe adhurojmë vetëm Atë, duke ndjekur urdhëresat e Tij dhe duke u larguar nga çka Ai na ka ndaluar.


Është e natyrshme dhe e logjikshme të arrihet në konkluzion se kjo botë kaq komplekse dhe e balancuar nuk mund të ekzistonte veçse duke qenë e krijuar nga Allahu, Zoti i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.





Prandaj është e pakuptimtë të thuhet se kjo botë është vetëkrijuar apo gjendet si rezultat i ndonjë rastësie.

### 2. Besimi në ëngjëjt (melaiket)

Ëngjëjt janë qenie të krijuara nga drita, nuk e kundërshtojnë Allahun dhe bëjnë atë që janë të urdhëruar.

Allahu na ka treguar diçka nga detajet e disa prej tyre; si Xhibrili; i cili zbret shpalljen e Allahut nga qielli te Profetët, ëngjëlli i vdekjes; merr shpirtat e njerëzve... etj.





### 3. Besimi në Librat e zbritur

Allahu ka zbritur shpalljen e Tij te Profetët si udhëzim dhe mëshirë për mbarë njerëzimin. Besimi në Librat e zbritura përfshin besimin në Teurat dhe Ungjill, të zbritur te Musai dhe Isai, si dhe besimin në Kur'an, i cili i është zbritur Muhamedit (paqja e Allahut qoftë mbi ta).

- Kurani është fjala e Allahut dhe shpallja e fundit e zbritur për njerëzimin, në të ka shumë argumente të qarta dhe mrekulli që tregojnë se ai është fjala e Allahut.
- Kurani përmban mesazh të qartë, të pastër dhe gjithëpërfshirës duke ju drejtuar ideve dhe besimeve të njeriut në lidhje me Allahun, Zotin e gjithësisë.
- Kurani i është zbritur Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), i cili ka qenë analfabet, e megjithatë ai përmban një stil unik të njohur botërisht si kulmi i elokuencës gjuhësore arabe dhe bukurisë së të shprehurit.
- Kur'anit është zbritur 1400 vite më parë, e megjithatë në të ka shumë fakte shkencore të cilat nuk kanë qenë të njohura për njerëzit e asaj kohe, vërtetësia e të cilave është zbuluar së fundmi nga shkenca.
- Kur'anit është ruajtur fjalë për fjalë në gjuhën origjinale në të cilën është zbritur, ndryshe nga Librat e tjerë të cilët janë ndryshuar, shtrembëruar apo humbur.

*Një tjetër mrekulli e Kur'anit është që nuk ka asnjë gabim apo kontraditë në përmbajtjen e tij.*

Shpjegimi më i arsyeshëm për shumë nga veçoritë dhe mrekullitë e Kuranit është që ai ka zbritur nga Allahu.

Kur'anit bashkë me thëniet dhe veprimet autentike të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) janë burimi i njohurive dhe shkencave islame.

### 4. Besimi në Profetët e Allahut

Muslimanët besojnë se mijëra Profetë janë dërguar nga Allahu, te paktën një për çdo popull. Të gjithë Profetët kanë ardhur me të njëjtin mesazh: Adhurimin e Zotit të Vetëm dhe ndjekjen e udhëzimeve të Tij. Prej tyre ka qenë Ademi, Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi (paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ta).




Misioni i tyre ka qenë thirrja e njerëzve në adhurimin e Allahut, Zotit të Vetëm. Ata ishin shembull për pasuesit e tyre dhe udhëzim për njerëzit drejt rrugës së shpëtimit.

Askush nga Profetët nuk i ngjason Allahut në cilësitë e Tij, e për këtë shkak; adhurimi ose konsiderimi i tyre si ndërmjetës mes Allahut dhe njeriut bie ndesh me bazën themelore të besimit; veçimin e Allahut në adhurim, i cili është detyrë për gjithë njerëzimin.

#### I Dërguari i Allahut Isai (paqja qoftë mbi të)

Muslimanët besojnë se Isai (Jezusi) është një prej Profetëve të cilin Allahu e ka nderuar. Lindja e tij ishte një prej mrekullive të Allahut, pasi që u lind nga nëna e tij - Merjemi (Maria) e cila ishte e virgjër -, pa baba. Allahu i mundësoi atij mrekulli të shumta; ai mundi t'i kthente të verbërit shikimin, të shurdhërit dëgjimin, dhe të shërontë atë që vuante nga sëmundjet e lëkurës.

Prej mrekullive të tij gjithashtu, ishte që ai foli kur ishte foshnje në djep, duke mbrojtur nënën e tij kundër shpifjeve që e akuzonin atë për imoralitet. Megjithëse muslimanët e duan dhe e respektojnë Isain (paqja qoftë mbi të) - sikurse dhe të gjithë Profetët e tjerë -, veçse ata



nuk e adhurojnë atë, e as e konsiderojnë atë si bir të Zotit, e as besojnë që ai bashkë me Atin dhe Shpirtin që të tre së bashku janë Zot! I lartësuar qoftë Allahu nga shpifjet. Muslimanët besojnë se askush nuk i ngjason Allahut në atributet e Tij dhe se vetëm Atij i takojnë adhurimet e askujt tjetër veç Tij.

Thotë Allahu i Lartësuar: “Nuk i takon Allahut që të ketë fëmijë, i Lartësuar qoftë Ai, kur Ai dëshiron diçka vetëm i thotë atij “bëhu”, dhe ai menjëherë bëhet. (Kur’ani 19;35).

**Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të)**

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) është i Dërguari i fundit i Allahut, të cilin e dërgoi me udhëzimin dhe Fenë e vërtetë për gjithë krijesat dhe i zbriti atij Kur’anin. Ai e sqaroi Kur’anin me fjalët, veprat dhe qëndrimet e tij, zbatoi urdhëresat e Kur’anit dhe ju përmbajt ndalesave të tij.

Ai ishte shembull për tu ndjekur në besueshmëri, mëshirë, tolerancë dhe sinqeritet. Muslimanët nuk e adhurojnë Muhamedin, sikurse nuk adhurojnë Isain apo dikë tjetër nga të Dërguarit e Allahut (paqja qoftë mbi ta).

**5. Besimi në Ditën e Gjykimit**

Dita e Gjykimit është një ndodhi e pashmangshme, atë ditë çdo njeri do të dalë përpara Krijuesit të tij, i cili do ta pyes e do ta marrë në llogari për të gjitha

veprat e kryera, qofshin ato të mëdha apo të vogla, të mira apo të këqija, të gjithë do të gjykohen me mëshirën e më Bujarit dhe drejtësinë e më të Drejtit, të Gjithëdijshmit.

Atë ditë, çdokush do të gjykohet me drejtësi, e askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi qoftë edhe sa një grimcë e vogël. Ata të cilët i janë bindur Allahut në këtë botë do të marrin shpërblimin e merituar e do të gëzohen, ndërsa ata të cilët nuk i janë bindur urdhërave të Tij do të ndëshkohen dhe do të dëshpërohen.




Çështja e njerëzve atë ditë do të jetë mes drejtësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij; ata do të jenë në Xhenet me mëshirën e Allahut ose në Zjarr me drejtësinë e Tij.

*Sikur mos të ishte Dita e Gjykimit, jeta jonë në këtë botë do të ishte padrejtësi. Sprovat dhe fatkeqësitë që na ndodhin do të ishin thjesht rastësi, e nuk do të kishin lidhje me urtësinë e Allahut, i Lartësuar qoftë Allahu nga kjo.*

**6. Besimi në Kader (përcaktimin e Allahut).**

Allahu është i Gjithëdijshëm, di çka ka ndodhur e çka do të ndodhë, di atë çka nuk ekziston se si do të ishte nëse do të ekzistonte. Në Dorën e Tij është fati i çdo gjëje, asgjë në këtë botë nuk ndodh veçse me dijeninë, lejimin dhe urtësinë e Tij, asgjë nuk ndodh jashtë fuqisë së Tij. Ai i ka dhënë çdo individ të drejtën e zgjedhjes mes rrugës së besimtarëve dhe rrugëve të jobesimtarëve, e më pas do ta marrë atë në llogari dhe do ta shpërblej për zgjedhjen që ka bërë; me Xhenet ose Zjarr.

E drejta e zgjedhjes që ka çdo individ nuk bie në kundërshtim me dijen e Allahut, i Cili di çdo gjë. Lejimi i Tij që diçka të ndodh nuk do të thotë që fuqia e Tij ndikon në lirinë e zgjedhjes së njeriut, apo e kushtëzon atë. Dija e Allahut se çfarë do të bëj njeriu nuk do të thotë që Ai e detyron atë të bëjë diçka jashtë dëshirës dhe zgjedhjes së tij, sikurse nuk do të thotë gjithashtu që Allahu do dhe pëlqen çdo gjë të cilën e lejon të ndodh.



# Pesë shtyllat e adhurimit (Shtyllat e Islamit)

Shtyllat e jetës së muslimanit

## 1. Besimi

Deklarimi i besimit në Zot bëhet duke dëshmuar se nuk ka Zot që meriton të adhurohet veç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij.

Kjo dëshmi duhet të bazohet në besimin e thellë në zemër, të shoqëruar me sinqeritet, duke e shqiptuar atë si dhe duke punuar me kuptimin e saj.

Më këtë dëshmi njeriu mohon çdo gjë që adhurohet veç Allahut, dhe beson se vetëm Allahu është Zoti i Vërtetë, e çdo gjë tjetër që adhurohet veç Tij është e rreme, dhe beson se Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është Profeti dhe i Dërguari i fundit; me këtë dëshmi njeriu bëhet musliman.

## 2. Falja e pesë namazeve

Namazi krijon lidhje shpirtërore mes njeriut dhe Zotit të tij. Baza e kësaj lidhje është besimi, dashuria dhe mendimi i mirë për Allahun e shoqëruar me shenjtërimin dhe madhërimin e Tij.

Ato marrin nga dita e njeriut një kohë të shkurtër, vetëm disa minuta. Namazi përbëhet nga leximi i Kur'anit, lutja dhe madhërimi i Allahut.

Përpara se muslimani të fal namaz duhet të pastrohet duke larë disa pjesë të trupit në mënyrë që të jetë i pastër nga ana trupore dhe shpirtërore.

*Pesë namazet janë shtylla më e rëndësishme e Islamit pas dy dëshmimeve. Pesë namazet janë: mëngjesi, dreka, ikindia, akshami dhe jacia.*

## 3. Dhënia e zekatit

Dhënia e zekatit është prej detyrimeve të cilat Allahu i ka obliguar muslimanit në pasurinë e tij nëse ajo arrin disa kriteret e caktuara.

Dhënia e zekatit bëhet duke nxjerrë një pjesë të vogël të pasurisë në mënyrë vjetore dhe shpenzohet sikurse e ka cekur Allahu në Kur'an (9:60) ku ka përmendur se zekati i takon të varfërve, nevojtarëve ..etj.

Zekati e pastron pasurinë e njeriut dhe bëhet shkak për shtimin e saj, dhe i sjell dobi personit që e jep si dhe atij që e merr.




Prej fryteve të dhënies së zekatit është që ai minimalizon diferencën mes të pasurit dhe të varfërit dhe i siguron çdo individ nevojat e tij bazike.

## 4. Agjërimi i Ramazanit

Muslimanët gjatë çdo viti agjërojnë muajin e Ramazanit, duke ju larguar ushqimeve, pijeve dhe mardhënieve intime gjatë ditës, nga mëngjesi i hershëm deri në perëndimin e diellit.

Agjërimi është pastrim shpirtëror dhe stimulus i durimit dhe vetëpërbajtjes, si dhe përmban dobi të shumta shëndetësore.

*Ramazani është muaji i nëntë sipas kalendarit islam hënor.*



## 5. Kryerja e Haxhit

Prej obligimeve fetare të cilat kërkohen nga çdo musliman nëse ai ka mundësi fizike dhe ekonomike është kryerja e Haxhit, të paktën një herë të vetme gjatë jetës.

Haxhi është eveniment vjetor që kryhet në muajin Dhul – Hixhe (muaji i dymbëdhjetë hënor). Ai pasqyron unitetin e muslimanëve gjatë kryerjes së adhurimit të Allahut pa dallim ngjyre, race, etnie, pozite apo moshe.

Kryerja e haxhit përfshin një mori ibadetesh dhe veprash të mira; si kurhani, shkuarja në Mekë, falja në vënde të ndryshme ....etj. Haxhi është një eksperiencë e veçantë gjatë së cilës njeriu fiton modesti, durim dhe butësi.

## Koncepti i adhurimit

Çdo gjë të cilën Allahu e do dhe kënaqet me të

Koncepti i adhurimit në Islam nuk kufizohet vetëm te pesë kushtet e Islamit, ai përfshin të gjitha veprat të cilat Allahu i do dhe kënaqet me to. Veprat e përditëshme mund të kthehen në adhurime nëse muslimani i kryen ato me sinqeritet dhe në mënyrën e duhur, si psh: buzëqeshja, mirësia ndaj prindërve, ndaj komshiut, ndihmesa e të afërmeve, besnikëria, ... madje edhe largimi i pengesës nga rruga.

Duhet të kihet parasysh që Allahu nuk ka nevojë për adhurimet e askujt, përkundrazi; njeriu ka nevojë për adhurimin e Allahut në mënyrë që të pastroj veten e tij.

## Përfundim

Shtyllat e besimit dhe të Islamit përbëjnë thelbin e Islamit dhe bazën e tij.

Praktikimi dhe zbatimi i shtyllave të besimit dhe Islamit përmbush nevojat shpirtërore, trupore, mendore dhe shoqërore në jetën e çdo individi dhe është mënyrë jetese praktike dhe racionale.

Për më tepër ajo është mënyra e vetme e jetesës të cilën Allahu e pranon dhe e vetmja rrugë e cila e shpie personin në Xhenet.

“Kush bën vepra të mira – qoftë mashkull apo femër – duke qenë besimtar; Ne do ti japim një jetë të mirë në këtë botë, e në botën tjetër do ti japim shpërblimin më të mirë për veprat që kanë kryer”. Kur’ani (16:97)



**HOTLINE**




**+971 56 204 2045**



**islamicicdxb**



# CONTENTS



# Pesë shtyllat e Islamit


Parimet themelore të jetës së muslimanit

ALBANIAN

(02/08)

أركان الإسلام

FREE COPY





Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

مركز المعلومات الإسلامي

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري  
Islamic Affairs & Charitable Activities Department

www.islamicic.com



# Parathënie

Çdo ndërtesë duhet të bazohet në themele të forta në mënyrë që jetë e qëndrueshme. Themelet mbi të cilat ngrihet feja Islame janë pesë, e ato përbëjnë esencën e mësimëve të Islamit, ashtu sikurse na i ka mësuar Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) duke thënë:

**Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla:**

1. Dëshmia se nuk ka Zot që meriton të adhurohet veç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij.
2. Falja e namazit.
3. Dhënia e zekatit.
4. Agjërimi i muajit të Ramazanit.
5. Kryerja e Haxhit.

Pesë shtyllat e islamit janë shtyllat e jetës së muslimanit.

## 1. Dëshmia se nuk ka Zot që meriton të adhurohet veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij

Kjo dëshmi e nxjerr njeriun nga mosbesimi dhe e shpie atw në besim. Ajo buron nga besimi thellë në zemër, e më pas ky besim përkthehet në shqiptimin e saj me gojë, e në këtë mënyrë përmbushen kushtet e dëshmisë së besimit.

Pjesa e parë e kësaj dëshmie përmbanë:


- Askush nuk meriton të adhurohet veç Allahut, qoftë ai njeri, gur, Profet...etj. Fjala "Allah" përdoret vetëm për Zotin e Vërtetë e të Vetëm.
- Allahu i vetëm është Krijuesi, Formuesi, në Dorën e Tij është gjithcka dhe Ai është i fuqishëm mbi çdogjë.
- Atij i përkasin të gjitha atributet e përsosura dhe është i Lartësuar nga çdo mangësi.
- Allahu nuk ka ortak, rival, prind apo fëmijë.

Pjesa e dytë e dëshmisë së besimit është se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Allahut, Profeti i fundit me të cilin Allahu vulosi zinxhirin e Profetëve. Allahu e dërgoi atë për mbarë njerëzimin që ti ftoj ata në adhurimin e Allahut dhe njehsimin e Tij.

Allahu e dërgoi Muhamedin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe i zbriti atij Kur'anin - shpalljen e fundit të zbritur në Tokë - që t'i mësoj njerëzve shkakun përse ata janë krijuar dhe të jetë për ta shembull për t'u ndjekur.

Prej dobive të dëshmisë së besimit:

- E bën njeriun që të arrij gradën e nënshtrimit të plotë ndaj Allahut, të jetë rob i vërtetë i Tij e të mos adhuroj askënd tjetër veç Tij.



- E bën njeriun të arrij në një gradë të lartë të respektimit dhe i jep atij vetbesim, e në të njëjtën kohë e bën atë modest dhe të përlur.
- E bën atë të jetë i guximshëm, i durueshëm, trim, si dhe të jetë i bindur ndaj Allahut.
- E bën njeriun që të bindet dhe urdhërave të Allahut dhe të përmbahet ndalesave të Tij.

## 2. Falja e namazit

Falja e pesë namazeve është shtylla më e rëndësishme në Islam pas dy dëshmimeve, e në bazë të saj krijohet jeta islame.

Kohët e këtyre namazeve janë: mëngjesi, dreka, ikindia, akshami (perëndimi i diellit) dhe jacia (darka).

Thotë i dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të): "kreu i çështjes është Islami, dhe shtylla e tij është namazi".

Namazi krijon një lloj lidhje shpirtërore mes njeriut dhe Zotit të tij, shtylla e kësaj lidhje është besimi i shoqëruar me madhërimin e Allahut.

Nëse njeriu e fal namazin me përkushtim dhe sinqeritet; ai do të jetoj një jetë të lumtur dhe të qetë e cila do ta afrojë atë më shumë ndaj Zotit të tij.

Namazi është shtylla e jetës së muslimanit, sikurse është gjithashtu edhe shtyllë e Islamit. Falja e namazit është rruga më e përshtatshme dhe më e shkurtër nëpërmjet së cilës arrihet nënshtrimi ndaj Allahut. Ai mund të falet në çdo vend të pastër; në fushë, zyrë, punë, shkollë ..etj, dhe kërkon një kohë të vogël, vetëm disa minuta.

Namazi përbëhet nga leximi i Kur'anit, lutja dhe madhërimi i Allahut, të ndara në disa lëvizje trupore të caktuara.

Gjatë faljes së namazit njeriu kujton madhësinë e Allahut, i lutet Atij për nevojat që ka dhe shpreson pranimin e lutjes së tij.



Përlurja dhe modestia e njeriut përpara Allahut në mënyrë të vazhdueshme e ndalon njeriun nga kryerja e gjynaheve dhe e pastron atë. Thotë Allahu i Lartësuar: "Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar".

(Kur'ani 29:45).

Namazi – gjithashtu – është mundësi për rinovimin e pendesës dhe kërkimin e faljes nga Allahu, bile namazi në vetvete i fshin gjynahet.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i

*"Me të vërtetë,  
Unë jam Allahu, s'ka  
zot tjetër përveç Meje,  
prandaj, vetëm Mua më  
adhuro dhe kryej faljen  
për të më kujtuar Mua!"  
(Kur'ani 20:14).*



pyeti shokët e tij një ditë: "Si mendoni nëse para derës së dikujt do të kalonte një lum, a do të ngelej në të ndonjë papastërti?" jo - u përgjigjën ata - nuk do të ngelej në të asnjë papastërti. "kështu janë pesë namazet, Allahu i fshinë me to gjynahet" tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).

### 3. Dhënia e zekatit

Çdo gjë që ne shohim është në Dorën e Allahut, e të gjithë ne jemi robë të Tij. Nuk ekziston në këtë botë diçka veçse Allahu është Krijuesi dhe Zotëruesi i saj, përfshi këtu edhe pasurinë që ne posedojmë, të cilën Allahu na e ka dhënë që ta shpenzojmë në mënyrën që Ai do.

Dhënia e zekatit është obligim për çdo musliman, sipas disa kriterëve dhe kushteve specifike, si psh: mbushja e moshës së obligimit, logjika, arritja e një shume të caktuar në pasuri ...etj).

Dhënia e zekatit bëhet duke nxjerrë 2.5% të pasurisë njëherë në vit sipas kushteve të përmendura, dhe shpërndahet sikurse e ka cekur Allahu në Kur'an: "për të varfërit, të pamundurit ...".

Thotë Allahu i Lartësuar: "Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira!" (Kur'ani 9:103).

Fjala "Zekat" do të thotë në gjuhën arabe: pastrim dhe shtim, ajo ngjason me pastrimin dhe kujdesjen ndaj bimëve, gjë që bëhet shkak që ato të shtohen.

Muslimani me dhënien e zekatit pastron pasurinë e tij, si dhe siguron që ajo do të shtohet e do të ket në të bereqet.


Prej dobive të Zekatit:

- Pastron besimtarin nga sëmundjet e zemrës; si tamaja dhe egoizmi.
- E trajnon njeriun që të ketë ndjesi dhe mëshirë për të varfërit.
- I kujton atij që të falenderoj Allahun për mirësitë me të cilat e ka furnizuar.
- Ngushton diferencën mes të pasurve dhe të varfërve.
- Pakëson varfërinë, dhe i garanton të varfërve një pjesë prej pasurisë së të pasurve.

Thotë Allahu i Lartësuar - duke përmendur dobitë e dhënies së zekatit -: "... në mënyrë që ajo të mos qarkullojë vetëm në duart e të pasurve nga mesi juaj". Kur'ani (59:7).

Besimtari mund të nxjerr krahas zekatit edhe lëmoshë në mënyrë vullnetare sipas dëshirës së tij.

*"Ata që kryejnë namazin, japin zekatin dhe besojnë bindshëm në jetën tjetër. Ata janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuar" (Kur'ani 31:4-5).*



## 4. Agjërimi i Ramazanit

Ashtu si çdo adhurim, edhe te agjërimi kërkohet nënshtrim ndaj urdhërave të Allahut, përkushtim dhe sinqeritet.

Muslimanët agjërojnë gjatë çdo viti mujin e Ramazanit i cili është muaji i nëntë sipas kalendarit hënor. Agjërimi kryhet dukë u larguar nga tre prej nevojave më kryesore të njeriut: ngrënia, pirja dhe mardhëniet intime prej mëngjesit të hershëm e deri në perëndimin e diellit.

*Thotë Allahu i Lartësuar: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat". (Kur'ani 2:183).*

Gjithashtu, gjatë agjëritimit njeriu i largohet gjynaheve dhe mëkateve, sidomos në muajin e Ramazanit.

Agjërimi i muajit të Ramazanit është obligim për çdo musliman i cili ka arritur moshën e pjekurisë, ka aftësi mendore dhe ka mundësi fizike. Fëmijët, të sëmurët, ata të cilët nuk kanë aftësi mmendore dhe të mëdhnjtë në moshë që nuk e përballojnë dot agjërimin; të katërta këto kategori nuk e kanë obligim agjërimin. Gjithashtu edhe gratë me menstruacione, lehonat dhe udhëtarët.

Prej dobive të agjëritimit:

- Është inkurajim dhe pastrim për njeriun.
- Përmban dobi të shumta trupore, sikurse e ka vërtetuar mjekësia.
- Ndjesia ndaj të varfërve të cilët nuk mund të hanë në çdo kohe, dhe kjo e shtyn njeriun që t'i ndihmojë ata më diçka nga pasuria e tij.
- I mëson njeriut vetëpërmbytjen dhe durimin.
- Pastron zemrën e njeriut dhe ja lehtëson atij sakrificën dhe durimin gjatë bindjes ndaj Allahut.
- E largon njeriun nga epshet dhe e bën atë të qëndrueshëm.
- Krijon një ndjesi dhe unitet mes agjëruesve.
- Është shkak për faljen e gjynaheve.



Thotë i dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të): "Kush agjëron muajin e Ramazanit duke besuar dhe shpresuar shpërblimin e Allahut; i falen atij të gjitha gjynahet e mëparshme".

## 5. Kryerja e Haxhit

Prej obligimeve fetare të cilat kërkohen nga çdo musliman që ka mundësi fizike dhe ekonomike është kryerja e Haxhit, të paktën një herë të vetme gjatë jetës.

*Thotë Allahu i Lartësuar: "Allahu e ka obliguar kryerjen e Haxhit për këdo që ka mundësi". (Kur'ani 3:97).*

Kryerja e Haxhit konsiderohet si një ndalesë e përkohshme e të gjitha



aktiviteteve të përditshme të njeriut, në të cilën ai ndjen flladin e mëshirës së Allahut.

Aty muslimani shfaq nënshtrimin e tij ndaj Allahut dhe kërkon mëshirën dhe faljen e Tij.

Haxhi është eveniment vjetor që kryhet në muajin Dhul – Hixhe (muaji i dymbëdhjetë hënor). Ai pasqyron unitetin e muslimanëve gjatë kryerjes së adhurimit të Allahut pa dallim ngjyre, race, etnie, pozite apo moshe.

Gjatë Haxhit të gjithë veshin të njëjtat rroba- ihramin - i pasuri e i varfëri, i forti e i dobëti, punëdhënsi e puntori; që të gjithë qëndrojnë të barabartë përpara Allahut.

Thotë Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) : "Kush kryen Haxhin dhe nuk flet fjalë të pahijshme e nuk vepron vepra të ndaluara; do të kthehet si ditën që e ka lindur nëna."

Haxhi është ndjekje dhe pasim i rrugës së Ibrahimit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) , sikurse ka treguar Profeti Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) .

Në të përmblihen një mori ibadetesh dhe veprash të mira; si kurbanit, shkuarja në Mekë, falja në vënde të ndryshme, tavafi rreth Qabes, ....etj, e të gjitha këto kryhen brenda një kohe të shkurtër gjatë haxhit.

Haxhi është një eksperiencë e veçantë gjatë së cilës njeriu fiton modesti, durim dhe butësi. Ai forcon vllazërinë mes besimtarëve pa dallim ngjyre, race apo etnie, pasi që të gjithë janë në të njëjtën fe.

## Përfundim

Allahu i lartësuar na i ka obliguar pesë shtyllat e Islamit, dhe çdo musliman duhet të besoj se është i obliguar me to dhe të përpiqet ti kryej ato në formën më të plotë e më të saktë. Zbatimi i pesë shtyllave të Islamit është praktik dhe i lehtë, ndërsa shpërblimi i tyre është tepër i madh.

Kryerja e tyre është shkak për mirqënien e individit dhe shoqërisë; ato forcojnë lidhjen dhe bashkpunimin mes njerëzve dhe i afrojnë ata më shumë me Allahun, Zotin e gjithësisë.

Allahu i madhëruar e ka bërë kryerjen e pesë shtyllave të islamit obligim për përmirsimin dhe pastrimin e njerëzve, jo se Ai ka nevojë për to. Me zbatimin e tyre ngrihet ndërtesa e besimit në zemrën e njeriut dhe i garantohet shpëtimi në këtë botë si dhe në botën tjetër.







+971 56 204 2045



islamicicdxb



# CONTENTS





ALBANIAN (03/08) النبي محمد ﷺ FREE COPY

*Duhet të njiheni me këtë njeri!*

www.daralber.ae |   Your Path To Peace..  مركز المعلومات الإسلامي Islamic Information Center *لتعريف بالإسلام*

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري | تصحيح رقم: (2017/139) | Islamic Affairs & Charitable Activities Department 

www.islamicic.com



# Kush është Muhamedi (paqja qoftë mbi të)?

Muslimanët besojnë se Muhamedi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) është hallka e fundit nga zinxhiri i gjatë i Profetëve që janë dërguar për të thirrur njerëzit në bindjen dhe adhurimin e Allahut, Zotit të vetëm.

*Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun. (Kur'ani 33:21)*

Disa nga këta profetë janë Ademi, Nuhu, Ibrahim, Ismaili, Is'haku, Ja'kubi, Jusufi, Musai, Daudi, Sulejmani, Isai (paqja qoftë mbi ta).

Muslimanët, sikurse besojnë që Musai (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) është dërguar me Teuratin (versionin origjinal dhe të pandryshuar) dhe Isait (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i është zbritur Ungjilli (versioni origjinal, e jo versionet e sotme), ata besojnë gjithashtu se Muhamedit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i është zbritur Kur'ani; për ti sqaruar njerëzve se çfarë kërkohet prej tyre.

Gruas së Profetit (paqja qoftë mbi të), Aishës i është kërkuar një herë të përshkruante Profetin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe ajo është përgjigjur „Moral i tij ishte Kur'ani”, që do të thotë se ai i ka zbatuar me kujdes mësimet e shenjta të Kur'anit në jetën e tij të përditshme.

Më poshtë do të tregojmë se si Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i kthente mësimet dhe udhëzimet e Kur'anit në vepra.

## I Dërguari i mëshirës



Profeti nuk i thërriste njerëzit vetëm në namaz, agjërim, bamirësi ... etj, por Ai (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i mësonte se besimi në Zot duhet të ndikoj edhe te mënyra se si njeriu sillet dhe i trajton njerëzit rreth tij.

*Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për gjithësinë. (Kur'ani 21:107).*

Thotë Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të): „Më i miri prej jush është ai që ka moralin më të mirë”.

Shumë thënie të Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) theksojnë lidhjen e ngushtë mes besimit dhe veprave. E një prej këtyre thënieve është:

Reference: [www.islamicpamphlets.com](http://www.islamicpamphlets.com)



„Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit mos t'i bëj keq komshiut të tij. Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit le ta respektojë mikun. Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit le të flasë mirë ose të heshtë”.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i mësoi njerëzit të tregojnë mëshirë me njëri-tjetrin, duke thënë: „Ai i cili nuk i mëshiron të tjerët; nuk do të mëshirohet”.

Në një transmetim tjetër, disa njerëz i kërkuan Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) që ti lutet Allahut ti dënojë mosbesimtarët, dhe ai tha: “Unë nuk jam dërguar si mallkues, por si mëshirë.”

## Falja

Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ishte njeriu më falës dhe më zemërmirë. Nëse dikush i bënte keq atij, ai e falte atë dhe sa më i madh të ishte dëmi që i bëhej; ai aq më i duruar bëhej. Ai ishte shumë tolerant dhe falës, sidomos kur kishte mundësi të ndëshkonte.

Ai (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ishte gjithmonë tolerant, dhe asnjë krim ose dhunim ndaj tij nuk ishte aq i madh sa të mos falej prej tij.

Ai ishte shembulli më perfekt i mirësisë dhe faljes, duke zbatuar Fjalën e Allahut të Lartësuar:

„Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!”. (Kur’ani 7:199).

## Barazia

Në hadithet e mëposhtme të Profetit (paqja qoftë mbi të), ai na mëson se të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara Allahut:




„Babai juaj është Ademi, e Ademi është krijuar nga balta. Nuk ka përparësi arabi nga jo arabi, as i ziu nga i kuqi, përveçse nëpërmjet devotshmërisë”.

Ai gjithashtu thoshte: „Allahu nuk shikon paraqitjet dhe pasuritë tuaja, por Ai shikon në zemrat dhe veprat tuaja”.

Është transmetuar se një burrë thirri një tjetër në një mënyrë ofenduese “Biri i një gruaje të zezë!” Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) u zemërua dhe ia ktheu: “A e ofendove atë për shkak të ngjyrës së nënës së tij? Te ti ka akoma gjurmë të injorancës (periudhës paraislame)”.

*Thotë Allahu i Lartësuar: „Le të falin dhe të mos mbajnë inat, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë”. (Kurani 24:22).*

*„Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij”. (Kur’ani 49:13).*



# Toleranca

*„Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë si mik i ngushtë”.  
(Kur’ani 41:34).*

Kur flitet për cilësitë e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) në librat e mëparshëm thuhet: “Ai nuk e kthente të keqen me të keqe, por me të mira dhe falje.”

Kështu i trajtonte Profeti ata që e sulmonin dhe i bënin keq.

Referencat islame na tregojnë për shumë raste kur Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ka pasur mundësi hakmarrje ndaj atyre që i kishin bërë padrejtësi, por ai gjithmonë zgjidhte mos të hakmerrej.

Ai i mësonte njerëzit të kishin durim në raste fatkeqësie.

Ai (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) thoshte: „I forti nuk është ai që mund të tjerët në përballje, por ai që kontrollon veten e tij gjatë zemërimit”.

Të qenurit durimtar dhe falës nuk do të thotë që muslimani mos ta mbrojë veten në rast sulmi.

Profeti Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) thotë: „Mos e ëndërroni përballjen me armikun, por kur të përballeni bëni durim (duke luftuar)”.

# Butësia

*„Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”.  
(Kur’ani 3:159).*

Enesi, njëri prej shokëve të Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i cili i shërbeu për dhjetë vjetë me radhë tregon se Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) gjithmonë ka qenë me të i butë, ai thotë: Asnjëherë nuk më tha për diçka që e bëra: „Pse e bëra”, e as për diçka që nuk e bëra: „Pse nuk e bëra”, dhe ishte njeriu më i dashur dhe më i butë.

Në një rast, gruaja e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) reagoi e zemëruar pasi e kishte ofenduar atë një person

Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) e këshilloi atë: “Ji e qetë o Aishe, Allahu është i Butë dhe pëlqen butësin në të gjitha punët.”

Ai gjithashtu ka thënë: „Butësia nuk gjendet në diçka veçse e zbukuron, e nuk hiqet nga diçka veçse e shëmton”.



# Përulësia

Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) i ndalonte njerëzit ti çoheshin në këmbë në shenjë respekti për të. Ai nuk vishte kurrë diçka që ta dallonte atë nga shokët e tij, u përziente me nevojtarët dhe të varfërit, u ulte me të vjetërit dhe i ndihmonte të vejat. Ata që nuk e njihnin atë nuk mund ta dallonin dot nga njerëzit e tjerë.

I Dërguari i Allahut thoshte duke ju drejtuar shokëve të tij: „Allahu ka shpallur te unë që të jemi modestë, në mënyrë që asnjëri mos të mburret para të tjerëve”.

Aq modest ishte (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) sa që kishte frikë mos njerëzit e adhuronin atë pas vdekjes, dhe thoshte:

*Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht (jo me mëndjemadhësi) nëpër Tokë, e kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqe qoftë!" (Kur'ani 25:63).*

„Mos më lavdëroni mua (mos i kaloni kufijtë) ashtu si bënë të krishterët me Isain, të birin e Merjemit. Unë jam vetëm rob i Allahut, prandaj thoni: Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij”.

# Bashkëshorti ideal

Gruaja e Profetit, Aisha ka thënë: „Ai gjithmonë ishte në shërbim të familjes së tij; qepte rrobat, rregullonte këpucët dhe punonte në shtëpi sikurse punon çdo person në shtëpinë e tij”.


Ai (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) nuk ishte thjesht një bashkëshort i mirë, por edhe inkurajonte shokët e tij të bënin të njëjtën gjë duke u thënë: „Besimtarët me besimin më të plotë janë ata që kanë moralin më të mirë dhe janë më të butë me gratë e tyre”.

# Shembulli ideal

Çfarë u përmend më sipër është vetëm një përshkrim i shkurtër i jetës së Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).

*„Jetoni e silluni mirë me gratë tuaja”. (Kur'ani 4: 19).*

Ata të cilët kanë krijuar përshtypje të gabuara në lidhje me Islamin për shkak të keqinterpretimeve që bëhen nëpër media e më gjërë do të ngelen të habitur nga shembujt e përmendur në të cilët tregohet mëshira, butësia, toleranca dhe modestia e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).



Është e rëndësishme që kur përpiqemi të kuptojmë Islamin të shkojmë te burimet dhe referencat e tij: Kur'ani dhe veprat e fjalët e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), dhe nuk është e drejtë ta gjykojmë Islamin nga veprimet ose gabimet e disa muslimanëve.

## Komente nga jo-muslimanë

Mahatma Gandhi - një politikan i madh dhe udhëheqës shpirtëror i lëvizjes së pavarësisë indiane - thotë: „ Ishte thjeshtësia e madhe e Muhamedit, realizimi i përpiktë i premtimeve të tij, përkushtimi i tij i madh për miqtë dhe pasuesit e tij, trimëria, burrëria, besimi i tij absolut në Zotin dhe në misionin e tij. Këto, bënë që të përhapej Islami dhe mposhtën çdo pengesë dhe jo shpata”.

„Vërtetë, ti posedon virtyte madhore”  
(Kur'ani 68:4).

George Bernard Shaw – dramaturgu dhe nobelisti i njohur irlandez -deklaron:

„Bota ka shumë nevojë për një njeri me mendësinë e Muhamedit. Nëse një njeri i tillë do të merrte drejtimin dhe udhëheqjen e botës moderne, do të arrinte t'i zgjidhte të gjitha problemet e saj dhe do të sillte paqe e lumturi për të gjithë.

Klerikët ne kohët e mesjetës - për shkak të injorancës ose keqdashjes – e paraqitën Islamin me një përshkrim tepër të errët dhe e konsideronin atë si armik të krishterizmit.

Unë, pasi studiova historinë e këtij burri mu duk e mrekullueshme dhe e veçantë, arrita në përfundimin se ai nuk ishte kurrë armik i krishterizmit, por duhet ti thuhet shpëtimtari i njerëzimit. Për mendimin tim, nëse atij do ti jepej kontrolli i botës së sotme, ai do të zgjidhte problemet tona dhe do të siguronte paqen dhe lumturinë për të cilën bota po vuan”.







+971 56 204 2045



islamicicdxb



# CONTENTS



# E vërteta rreth të dërguarit të Allahut ISAIT (JEZUSIT)

ALBANIAN (04/08) النبي عيسى عليه الصلاة والسلام FREE COPY

## Muslimanët e duan Isain (paqja qoftë mbi të)






Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

لتعرف بالإسلام

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري  
Islamic Affairs & Charitable Activities Department

www.islamicic.com



Isai është një person shumë i dashur nga miliona njerëz në botë, e megjithatë ekzistojnë shumë keqkuptime rreth statusit të këtij personaliteti kolosal. Muslimanët dhe të krishterët kanë vlerësim tepër të lartë për Isain (paqja qoftë mbi të) por e shikojnë atë në dy këndvështrime krejt të ndryshëm.

Kjo broshurë ka për qëllim të qartësojë keqkuptimet që lidhen me Isain (Jezusin): A është ai Zot, apo është i Dërguar nga Zoti? Kush është Isai i vërtetë?

## ISAI SI ZOT

Disa prej të krishterëve pretendojnë se Isai (Jezusi) është Zot, apo besojnë në trinitet, dhe se Jezusi është Zoti i cili u kthye në formë njeriu. E megjithatë, në librin e shenjtë të të krishterëve tregohet që Isai është i lindur, ha, pi, fle, falet, dhe se njohuritë që ai ka kanë një limit; e këto tipare nuk mund ti atribohen Allahut, Zotit të vërtetë.

Allahu ka atributet më të larta e të plota, ndryshe nga njeriu.

Atëherë si mundet që dy gjëra kontradiktore - të qenurit Zot dhe njeri - të bashkohen në të njëjtën kohë?!


Islami na mëson se Zoti është gjithmonë perfekt. Të besosh se Zoti u kthye në njeri do të thotë të mendosh se Zoti (në një moment caktuar) është ose ishte joperfekt. Një i krishterë duhet të pyesi veten, a beson se Zoti që ka qënë njëherë fëmijë i dobët, që nuk mbijetonte dot pa ushqim, ujë dhe gjumë; të jetë i njëjti Zoti i Madhërishtëm i përshkruar në Dhjatën e Vjetër? Sigurisht që JO!

Ndoshta dikush do të thotë: „Duke qënë se Allahu është i Fuqishëm të bëj çdo gjë; përse nuk është e mundur që Ai të bëhet njeri?” Sipas domethënies së fjalës „Zot”, Ai kurrësesi nuk ngjan me krijesat e Tij në tiparet e as në veprimet e tyre. Nëse Zoti bëhet si një prej krijesave të Tij ose merr tiparet e tyre; atëherë Ai s’do të ishte më Zot.

Disa vargje në Bibël, mund të kuptohet nga to gabimisht që Isai (paqja qoftë mbi të) është Zot. Por nëse shikojmë tek vargjet e qarta dhe direkte të Biblës, shikojmë që ato përsërisin në mënyrë të prerë se Isai (paqja qoftë mbi të) është i Dërguar i Allahut dhe njeri si gjithë njerëzit e tjerë, dhe asgjë më shumë. E për më tepër, në Bibël gjenden fragmente të shumta nga të cilat kuptohet se Isai (Jezusi) flet dhe vepron si një rob i Allahut, dhe se Allahu është i veçuar me qënien e Tij.

e disa nga këto fragmente janë:

- „ Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej”. (Mateu 26:39). E nëse Isai (Jezusi) do të ishte Zot, a do të kishte kuptim që Zoti të përkulej me fytyrë në tokë (të binte në sexhde)? Dhe kush do të ishte ai të cilit „Zoti” do ti përkulej?



- Bibla e cilëson Isain si një Profet [Mateu 21:10-11], atëherë si mundet që Isai të jetë Zot dhe Profeti i Zotit në të njëjtën kohë?
- Isai tha, „Unë po shkoj tek Ati, sepse Ati im është më i madh se unë.” [Gjoni 14:28]
- Isai tha: „Unë ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj.” [Gjoni 20:17] Nëse Isai do të ishte Zot, atëherë pse tha: „ te Zoti im dhe te Zoti juaj”, dhe tek kush po ngjitej ai?

Nëse Isai ishte Zot, ai do t'i thoshte njerëzve qartësisht ta adhuronin atë dhe do të kishte vargje të qarta në Bibël që e pohonin këtë. Krahas kësaj; ai bëri të kundërtën dhe qortoi e kundërshtoi çdokënd që e adhuronte atë: „Dhe më kot ata më adhurojnë.” [Mateu 15: 9]

## BIRI I ZOTIT

„Disa të krishterë pretendojnë se Isai është biri i Allahut”. I lartësuar qoftë Allahu nga të paturit bir. Çfarë do të thotë për Zotin të ketë fëmijë? Termi „bir i Zotit” perdoret në formën simbolike në gjuhët e vjetra biblike dhe kihet me të qëllim „njeriu i mirë”, sikurse është përmendur në shumë fragmente të Dhjatës së vjetër për disa nga Profetët të cilët kanë jetuar para Isait; si Daudi (Davidi), Sulejmani (Solomoni) dhe Israil (Israeli). Atëherë; ky term nuk është i veçantë për Isain. E në një nga këto fragmente tregohet kur Allahu dërgoi Musain te Faraoni, dhe prej fjalëve të Musait drejtuar Faraonit ishte: „Kështu thotë Zoti: Izraeli është biri im, i parëlinduri im”. (Eksodi 4:22)




*„Allahut nuk i shkon të marrë dikë për bir. Qoftë i lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të „Bëhu!” dhe ajo bëhet”. (Kurani 19:35).*

Pra çdo njeri i drejtë dhe i bindur ndaj Zotit mund të quhet në gjuhën biblike si „bir i Zotit”, sikurse është përmendur : „Të gjithë ata që udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë janë bij dhe bija të Perëndisë.” [Romakëve 8:14]

## ATI DHE PERËNDIA

Në të njëjtën mënyrë, fjala „Atë” kur përdoret drejtuar Zotit, nuk duhet të merret në kuptimin parësor. Ajo është një mënyrë të shprehuri që Zoti është Krijuesi, Mbështetësi dhe Mjeshtri suprem i gjithçkaje. Në Bibël përmenden vargje të shumta nga të cilat ne kuptojmë përdorimin simbolik të fjalës „Atë”, si për shembull: „Një Perëndi dhe Atë i të gjithëve.” [Efesianëve 4: 6]

Gjithashtu, dishepujt e Isait ndonjëherë e thërrisnin atë „Perëndi”. Ky term është përdorur në gjuhën origjinale të Biblës për Zotin dhe për njerëzit që janë në pozitë të Lartë. Për shembull, në Testamentin e Ri Grek, termi „kyrios” është përdorur edhe si „Perëndi” edhe për pronarin e vreshtës



[Mateu 20:8], edhe për mjeshttrin që ndëshkon shërbëtorin e pabindur [Luka 20.42-47].

Në fragmente të tjera të Biblës, Isai thirret edhe „shërbëtor” i Zotit nga dishepujt: „Perëndia i Etërve tanë e ka lëvduar shërbëtorin e vet Jezusin”. [Veprat 3:13]. Kjo qartësisht tregon se kur „Perëndi” përdoret drejtuar Isait është titull respekti dhe nuk kihet me të për qëllim të qenurit Zot.

## ISAI SI PROFET

Çifutët kanë mohuar që Isai (paqja qoftë mbi të) të jetë Mesia (shpëtimtari) i pritur, dhe të qenurit e tij shpëtimtar bie në kundërshtim me mësimet e Krishterizmit, pasi ai adhurohet si Zot ose bir i Zotit. Islami mban qëndrim të mesëm dhe pohon që Isai, i biri i Merjemit, është i Dërguar i besueshëm nga Allahu dhe gjithashtu Mesia i pritur. Muslimanët nuk e adhurojnë Isain sepse adhurimi i përket vetëm Allahut, të Lartmadhëruar, të Vetëm, i cili krijoi Isain dhe gjithçka që ekziston.

*„Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Un-gjillin), më ka bërë Profet”.  
(Kur’ani 19:30).*

## MREKULLIA E LINDJES SË ISAIT



Sipas Kur’anit, ëngjëlli Xhibril është dërguar tek Merjemi, virgjëresha fisnike, në formën e njeriut dhe e lajmëroi atë se ajo do të lindte një fëmijë, mrekullisht pa baba.

Ai (Xhibrili) tha: „Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.” Ajo (Merjemi) tha: „Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacipë?!” lu përgjigj: „Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë argument për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer” . (Kur’ani 19:19-21).

Disa pretendojnë se mrekullia e lindjes së Isait është provë e të qenurit të tij Zot, megjithëse, Isai nuk ishte i vetmi që erdhi në jetë pa baba. Profeti Adem (paqja qoftë mbi të) gjithashtu para tij nuk ka pasur as baba, e as nënë. Thotë Allahu i Madhëruar:

„Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit; e krijoi prej baltës e pastaj i tha: „Bëhu!” - dhe ai u bë. E vërteta është nga Zoti yt, andaj mos u bëj nga ata që dyshojnë!”. (Kur’ani 3: 59-60).

Nëse Isai adhurohet sepse ka lindur pa baba, atëherë Ademi – pa dyshim - meriton më shumë të adhurohet duke qenë pa baba dhe pa nënë.



## MREKULLITË E ISAIT (PAQJA QOFTË MBI TË)

Mrekullia e Isait (paqja qoftë mbi të) nuk ishte vetëm lindja e tij pa baba. Allahu i dha atij edhe mrekulli të tjera të mëdha.

Ai foli kur ishte bebe në djep duke mbrojtur nënën e tij kundër atyre që e akuzuan për imoralitet. Kur'ani gjithashtu na tregon se ai ngjallte të vdekurin me lejen e Allahut dhe shëronte zgjeben dhe verbërinë me lejen e Allahut gjithashtu.

Fakti që Allahu i dha Isait (paqja qoftë mbi të) këto mrekulli do të thotë se ai ishte shërbëtor i përlur ndaj Allahut, Zotit të gjithësisë. Shumë prej të Dërguarve Allahu i ka pajisur me mrekulli mahnitëse si Nuhu, Musai, Muhammedi ... etj (paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ta). Të gjithë këto mrekulli realizohen vetëm me dëshirën dhe lejen e Allahut, që të demonstron vërtetësinë e thirrjes së tyre.

## MESAZHI I ISAIT (PAQJA QOFTË MBI TË)

Vlen të theksohet se të gjithë Profetët e përmendur e Dhjatën e vjetër si Ibrahim, Nuhu, Junusi ... etj, nuk thanë kurrë se Zoti është pjesë e trinitetit dhe nuk besuan se Isai ishte shpëtimtari i tyre.

Mesazhi i tyre ka qënë shumë i qartë: ka një Zot dhe vetëm Ai meriton të adhurohet.





Nuk është llogjike që Allahu të dërgojë qindra Profetë gjatë mijëra viteve me të njëjtin mesazh thelbësor, e më pas ta ndryshojë atë papritur, të deklarojë se tani Ai është pjesë e një triniteti, se Isai është i biri i Tij dhe se ky është besimi që të shpëton!

E vërteta është që Isai (paqja qoftë mbi të) i thërriti njerëzit në të njëjtin besim që kanë thërritur në të gjithë Profetët e tjerë, pa asnjë ndryshim.

Në Bibël gjendet një citat që thekson këtë mesazh thelbësor, ku tregohet se një person shkoi te Isai (paqja qoftë mbi të) dhe e pyeti: "kush është urdhëresa e parë?" Isai (paqja qoftë mbi të) iu përgjigj: "Dëgjo, o Izrael, Zoti, Perëndia ynë, Zoti është një." [Marku 12: 28-29].

Pra, urdhëresa më e madhe dhe besimi më i rëndësishëm sipas Isait (paqja qoftë mbi të) është që Zoti është një. Nëse Isai do të ishte Zot ai mund të thoshte 'Unë jam Zoti, më adhuroni mua'. Por në vend të kësaj ai thjesht tha një varg nga Dhjata e vjetër duke konfirmuar që Zoti është një.

Kjo përputhet me misionin e Isait (paqja qoftë mbi të) dhe



me mësimet Islame, ku Isai është i Dërguari i Allahut tek çifutët për të konfirmuar mesazhin e Profetëve të mëparshëm - që të adhurohet vetëm një Zot i vetëm, Allahu i Madhëruar.

Isai ishte i ndershëm dhe i bindur ndaj urdhërave të Allahut, si i Dërguar dhe si rob i Tij. Ai ishte „Musliman”, sikurse çdo kush që i dorëzohet Allahut dhe të gjitha adhurimet ja dedikon vetëm Atij.

*„E kur Isai solli prova të qarta, tha: „Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t’ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni. Andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Pa dyshim, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është rruga e drejtë!”.*  
(Kurani 43: 63-64).

## ISAI NË ISLAM

Isai (paqja qoftë mbi të) ishte Profet i dërguar nga Allahu që të thërrasë njerëzit në adhurimin e një Zoti të vetëm.

Kjo është dëshmi e qartë në Bibël dhe e konfirmuar në Kur’an. Besimi Islam shpjegon se Allahu i dha Isait (paqja qoftë mbi të) shumë mrekulli, dhe në të njëjtën kohë ai (besimi Islam) nuk e cënon madhësinë dhe përsosmërinë e Allahut.

Të ftojme të kërkojmë më tepër rreth Islamit. Nuk është si çdo fe tjetër. Është i njëjti mesazh që i është shpallur edhe Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait dhe Muhammedit (paqja qoftë mbi të gjithë ata). Islami do të thotë „nënshtrim tek Allahu” dhe është një mënyrë jetese e plotë dhe e përbushur që e nxit njeriun në përmisimin e lidhjes së tij me Allahun dhe njerëzit. Islami na mëson që Allahu është i Drejtë, i Mëshirshëm, ska nevojë që të sakrifikojë veten për të falur ose mbuluar gjynahet dhe asnjë nuk është „I lindur në gjynah”. Allahu do të gjykojë çdo kënd në bazë të veprave të veta dhe të gjithë do të japin llogari për punët e tyre.

Islami na mëson ti duam dhe respektojmë të gjithë Profetët e Allahut, veçse dashuria dhe respekti ndaj tyre nuk nënkupton adhurimin e tyre; sepse ai i përket vetëm Allahut. Ta pranosh Isain si Profet të Zotit dhe të bëhesh musliman nuk do të thotë të ndryshosh ose humbësh identitetin tënd si i krishterë, por thjeshtë të kthehesh në mësimet e pastra dhe origjinale të Isait (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të).

**HOTLINE**




**+971 56 204 2045**



**islamicicdx**



# CONTENTS



# Cili është qëllimi i jetës?

ALBANIAN

(05/08)

الغاية من الحياة

FREE COPY

## Nga kam ardhur?

## Përse jam në këtë botë?

## Ku do të shkoj pas vdekjes?





Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

للتنوير بالإسلام

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري  
Islamic Affairs & Charitable Activities Department

www.islamicic.com



# CILI ËSHTË QËLLIMI I JETËS?

Prej pyetjeve të para të cilat na trokasën në kokë sa herë mendojmë për qëllimin e jetës është: "Nga kemi ardhur?"

A jemi në këtë botë për shkak të ndonjë rastësie apo falë veprës së Krijuesit të Përsosur? Besimi në ekzistencën e Krijuesit është hapi i parë drejt kuptimit të qëllimit real të të qenurit tonë në këtë botë.

Shkaqet logjike të besimit në ekzistencën e Krijuesit janë të shumta, përmendim tre prej tyre shkurtimisht:

## 1. Krijimi i universit

Argumenti i parë që tregon për ekzistencën e Krijuesit lidhet me të kuptuarit e origjinës së krijimit të kësaj bote.

Imagjino sikur të jesh duke ecur në një shkretëtirë dhe papritur gjen në të një orë dore. Të gjithë e dimë që ora përbëhet prej xhamit, plastikës dhe metalit; xhami merret nga rëra, plastika nga përpunimi i naftës dhe metali nxirret nga thellësitë e tokës; e të treja këto gjenden në shkretëtirë. Atëherë, a mendon se kjo orë është krijuar vetë? A mendon që një ditë lindi dielli dhe filloi të fryjë erë, e më pas nafta doli në sipërfaqe të tokës duke u përzier me rërën dhe metalin, e pas disa miliona viteve u formua kjo orë rastësisht, për shkak të koicidençes natyrore?


*Dikush mund të thotë: "Kush e ka krijuar Allahun"? Allahu është Krijuesi i gjithësisë dhe ndryshon nga krijesat. Allahu është i përherëshëm, ka qenë i tillë gjithmonë dhe nuk ka fillim, e për këtë shkak pyetja se kush e ka krijuar Atë është jashtë çdo koncepti logjik.*

Përvoja dhe logjika e shëndoshë tregojnë se çdo gjë ka një fillim e nuk gjendet rastësisht, e gjithashtu nuk mund të vetëkrijohet.

Prandaj, shpjegimi më i pranueshëm është që ekziston një Krijues i cili ka krijuar universin. Krijuesi Gjithëfuqishëm dhe Gjithëdijshtëm; që krijoi këtë botë dhe vendosi në të «rregulla natyrore» të cilat e sundojnë. E duke qenë kështu; atëherë mund të besojmë që ky Krijues nuk i nënshtrohet ligjeve natyrore të vendit e kohës për shkak se vendi dhe koha janë të krijuara, dhe kanë një fillim.

E të gjitha cilësitë e sipërpërmendura na shpjen në ekzistencën e Krijuesit të universit, Allahut.

Për ekzistencën e Allahut tregon edhe shkenca moderne duke vërtetuar që kjo botë ka fund, sikurse ka edhe fillim.



## 2. Krijimi perfekt i universit

Argumenti i dytë i cili tregon mbi ekzistencën e Krijuesit është ajo që ne shohim prej sistemit dhe balancimit perfekt i cili gjendet në këtë univers tepër të komplikuar.

Shumë prej veçorive të kësaj bote tregojnë qartë që janë të dizenuara veçanërisht për të krijuar mbarëvajtjen e jetës në këtë botë, si psh: Distanca e Tokës nga dielli, trashësia e bërthamës së Tokës, shpejtësia e rrotullimit të Tokës, përqindja e oksigjenit në atmosferë, grada e pjerrësisë së Tokës ....etj.

Nëse këto përmasa do të ndryshonin qoftë edhe pak; atëherë nuk do ishte e mundur jetesa në Tokë.

E duke pasur parasysh që ora e dorës ka një krijues i cili ka ditur se si ta regjistrojë kohën saktësisht; atëherë edhe Toka në të cilën jetojmë ka doemos një Krijues i cili e di shumë mirë kohën kur ajo rrotullohet rreth diellit.

A mundet që e gjithë kjo të ndodhë vetëvetiu?

Kur shohim gjithë këto rregulla dhe ligje natyrore perfekte në veten tonë si dhe kudo në këtë botë; A nuk është e logjikshme që të jetë dikush i cili e ka mirëorganizuar gjithë këtë?

Shpjegimi më i saktë në lidhje me këtë organizues kaq perfekt është ekzistenca e Allahut, i vetmi i cili ka krijuar gjithçka.





## 3. Shpallja e Allahut

Argumenti i tretë i cili tregon për ekzistencën e Allahut është shpallja, të cilën Allahu ja ka sjellë njezëve si tregues për ekzistencën e Tij.

Argumente të shumta e të qarta tregojnë se Kur’ani është fjala e Allahut, e më poshtë po përmendim disa argumente të cilat mbështesin këtë fakt:

- Kur’ani ka zbritur prej më shumë se 1400 vitesh, e megjithatë në të ka shumë fakte të vërtetuara nga shkenca moderne e sotme, të cilat nuk kanë qenë të njohura për njerëzit në atë kohë. E prej këtyre fakteve është: Uji është origjina e çdo qenie te gjallë. (Kur’ani 21:30). Zgjerimi i universit. (Kur’ani 51:47). Dielli dhe hëna, secili prej tyre ka orbitën perkatëse në të cilën noton. (Kur’ani 21:33).
- Kur’ani përmban shumë fakte historike të cilat nuk kanë qenë të njohura nga njerëzit në atë kohë, e aq më tepër në Kur’an ka parashikime për disa ndodhi, saktësia e të cilave është vërtetuar më vonë.
- Në Kur’an nuk ka asnjë gabim apo kundërshtim, megjithëse shpallja e tij ka zgjatur 23 vjet, dhe ka trajtuar një shumëllojshmëri temash.
- Kur’ani është ruajtur fjalë për fjalë ashtu sikurse ka zbritur në gjuhën e tij origjinale – në gjuhën arabe -, ndryshe nga librat e tjerë të zbritur; te cilat nuk gjenden më në formën e tyre origjinale.

*Allahu e ka zbritur Kur’anin si libër udhëzimi për gjithë njerëzimin, e duke qënë kështu; në të do të ketë patjetër argumente të qarta rreth ekzistencës së Allahut.*



- Kur'ani përmban mesazh të qartë dhe universal, drejtuar ideve dhe besimeve të cilat lidhen me Allahun.
- Kur'ani lë ndikim të thellë te njerzit, nuk e ndjen atë veçse ai i cili ka shijuar ëmbëlsinë e Kur'anit dhe besimit.
- Kur'ani i është zbritur të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (paqja qoftë mbi të) i cili ka qenë analfabet, e megjithatë Kur'ani përmban një mënyrë të shprehuri tepër unike dhe njihet botërisht si grada më e lartë e elekuencës dhe bukurisë gjuhësore arabe.

Atëherë; shpjegimi më i arsyeshëm i veçorive dhe mrekullive të cilat gjenden në Kur'an është që ai është vetëm nga Allahu.

## Allahu është Udhëzuesi

Kur ne besojmë që kemi ardhur në këtë botë nga një Krijues i Përsosur, jemi të bindur që Ky Krijues do t'na tregoj shkakun se përse na ka krijuar.

Si mund ta dimë se çfarë kërkon Allahu nga ne? A ta kalojmë jetën si një eksperiment, apo të jetojmë thjesht për të plotësuar dëshirat tona personale? A duhet të «ecim me rrymën» duke ndjekur të tjerët?

Jo. Allahu na ka dërguar Profetë dhe na ka zbritur libra qiellorë për t'na treguar shkakun se përse na ka krijuar.

Allahu ka dërguar mijëra Profetë , çdo popull ka pasur të paktën një të tillë, dhe të gjithë këta Profetë kanë përcjellë një mesazh të përbashkët: Adhurimin e Allahut, Zotit të vetëm dhe ndjekjen e udhëzimeve të Tij. Disa nga këta Profetë janë : Ademi, Nuhi, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi (paqja e Allahut qoftë mbi ta).

I Dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është Profeti i fundit i zinxhirit të të Dërguarve, ai ishte njeriu më i besueshëm, më i drejt, më i mëshirshëm dhe më i guximshëm. Allahu e dërgoi atë me shpalljen e fundit për banorët e Tokës, Kur'anin; që t'i shpjegoj njerëzve atë çka Allahu u ka zbritur, në mënyrë që të shpëtojnë.

Kur'ani është libër udhëzimi për njerëzimin, sqaron shumë prej koncepteve të cilat kanë angazhuar njerëzit, si psh:

Qëllimi nga ekzistenca jonë?



Kush është Allahu, dhe cilat janë veprat të cilat Ai i do dhe cilat janë ato vepra të cilat Ai i urren?

Historitë e Profetëve të mëparshëm dhe dobitë e përfituara prej tyre.

Përshkrimet e Xhenetit, Zjarrit dhe Ditës së Gjykimit.

Gjithashtu, Kur'ani synon qartësimin e përfytyrimeve dhe ideve të gabuara që lidhen me Allahun. Në të përshkruhen tiparet e Isait (Jezusit) dhe bëhet krahasimi i tipareve të tij me tiparet dhe cilësitë e Allahut.

*Isai (Jezusi) – sikurse edhe Profetët e tjerë – erdhi me disa mrekulli, dhe i ftoi njerëzit në adhurimin e Allahut, Zotit të vetëm. (Shiko: Kur'ani 19:36).*



# Natyra dhe tiparet e Isait

Disa prej të krishterëve pretendojnë se Isai (Jezusi) është Zoti, apo besojnë në trinitet, dhe se Jezusi është Zoti i cili u kthye në formë njeriu. E megjithatë, në librin e shenjtë të të krishterëve tregohet që Isai është i lindur, ha, pi, fle, falet, dhe se njohuritë që ai ka kanë një limit; e këto cilësi nuk mund ti atribohen Allahut, Zotit të vërtetë.

Allahu ka atributet më të larta e të plota, ndryshe nga njeriu.

Atëherë si mundet që dy gjëra kontradiktore - të qënurit Zot dhe njeri - të bashkohen në të njëjtën kohë, kjo është e papranueshme logjikshtë.

Ndoshta dikush do të thotë: «Duke qenë se Allahu është i Fuqishëm të bëj çdo gjë; përse nuk është e mundur që ai të bëhet njeri?»

Duke u nisur nga përkufizimi dhe kuptimi i fjalës «Zot», Zoti kurrësi nuk kryen diçka që tregon se Ai nuk është Zot, prandaj nëse Ai bëhet njeri dhe merr tiparet e njerëzve; atëherë nuk është më Zot.

E për më tepër, në Bibël gjenden fragmente të shumta nga të cilat kuptohet se Isai (Jezusi) flet dhe vepron si një rob i Allahut, dhe se Allahu është i veçuar me qënien e Tij.

Për shembull: " Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej". (Mateu 26:39).

E nëse Isai (Jezusi) do të ishte Zot, a do të kishte kuptim që Zoti të përkulej me fytyrë në tokë (të binte në sexhde)?

Dhe kush do të ishte ai të cilit "Zoti" do ti përkulej?

"Disa të krishterë pretendojnë se Isai është biri i Allahut".

Këtu pyesim veten tone se çfarë do të thotë kjo ekzaktësishtë.

I lartësuar qoftë Allahu nga të paturit bir.

E për më tepër, gjejmë që termi «bir i Zotit» perdoret në formën simbolike në gjuhët më të vjetra biblike dhe kihet me të qëllim «njeriu i mirë», sikurse është përmendur në shumë fragmente të Dhjatës së vjetër për disa nga Profetët të cilët kanë jetuar para Isait; si Daudi (Davidi), Sulejmani (Solomoni) dhe Israil (Israeli).

Atëherë; ky term nuk është i vecantë për Isain.

E në një nga këto fragmente tregohet kur Allahu dërgoi Musain te Faraoni, dhe prej fjalëve të Musait drejtuar Faraonit ishte: "Kështu thotë Zoti: Izraeli është biri im, i parëlinduri im". (Eksodi 4:22).

Feja Islame sqaron se kush është Isai i vërtetë (paqja qoftë mbi të), duke ju përmbajtur besimit të saktë karshi Allahut, Madhërisë, Njëshmërisë dhe Përsosmërisë Tij.

Isai (paqja qoftë mbi të) është Profet i nderuar, të cilin Allahu e dërgoi për të ftuar njerëzit në adhurimin e Një Zoti të vetëm, Allahut.

*Njohja e natyrës dhe tipareve të Isait (paqja qoftë mbi të) është shumë e rëndësishme nëse duam të njohim kuptimin e termit «Zot» në Islam, dhe kjo, për shkak të pretendimeve të rreme rreth natyrës së Isait (paqja qoftë mbi të)*

*«Nuk i shkon Allahut që Ai të ketë bir, i lartësuar është Ai nga kjo». (Kur'ani 19:35).*



## Përse unë jam këtu?

Të gjithë jemi koshientë që çdo pjesë e trupit të njeriut si sytë, veshët, truri, zemra ..etj, ekzistenca e tyre është për një qëllim të caktuar.

A nuk tregojnë kjo që edhe ekzistenca e çdo individit – në formën e tij të plotë - ka një qëllim të caktuar gjithashtu.

Allahu nuk na ka krijuar që thjesht të sillemi rrotull pa kurrfarë qëllimi, nuk na ka krijuar që vetëm të përmbushim dëshirat dhe instiktet tona.

Ne jemi krijuar për një qëllim madhor; dhe ky qëllim është të njohim Allahun – Zotin e gjithësisë - dhe ta adhurojmë Atë, në mënyrë që të jetojmë sipas udhëzimeve të Krijuesit tonë, dhe atëherë do të mund të kemi një jetë të suksesshme dhe me harmoni në të gjitha aspektet.

Udhëzimet e Allahut përfshijnë adhurimet individuale (dobia e të cilave i kthehet personit i cili i kryen ato; si psh: namazi, agjërimi ..etj) si dhe ato adhurime dhe vepra të mira dobia e të cilave kthehet te rrethi shoqëror në të cilin jetojmë (si psh: sjellja e mirë me prindërit, fqinjësi e mirë, përkujdesja ndaj familjes, ruajtja e porosisë...etj).

Allahu ka ndaluar të adhurohet dikush tjetër veç Tij, kushdo qoftë (qoftë ai ndonjë idhull, hëna, dielli, prift, hoxhë apo edhe Profet). Allahu nuk ka nevojë për ortak e as për ndërmjetës, gjithkush mund të afrohet te Ai duke e adhuruar Atë, pa patur nevojë për ndërmjetës.

Allahu e ka quajtur këtë botë si testim, dhe format e këtij testimi janë të ndryshme për njerëzit. Ne nuk mund të kontrollojmë se çfarë mund t'na ndodh, por mund të kontrollojmë reagimet tona.

Prej mënyrave të cilat na afrojnë te Allahu dhe janë shkak për futjen në Xhenet janë: durimi ndaj fatëkeqësive dhe falenderimi i Allahut karshi mirësive.

Allahu na ka paralajmëruar nga dënimi i Zjarrit nëse ne nuk besojmë ose nuk i bindemi urdhërave të Tij.

## Atëherë ... çfare duhet të bëj unë tani?

Testimi i besimit të personit është që ai të përdor logjikën dhe intelektin e tij për të njohur argumentet e ekzistencës së Allahut, dhe të bindet Atij në atë çka ka urdhëruar apo ndaluar. Kjo bindje ndaj Allahut do të thotë në gjuhën arabe: "Të jesh musliman".

Allahu e ka mundësuar pranimin e Islamit për të gjithë, pa marrë parasysh të kaluarën, bindjet apo gjëndjen aktuale të individit. Prandaj, çdo njeri mund të bëhet musliman duke besuar dhe shqiptuar atë që përmban kjo dëshmi - dëshmia e besimit -:

**Esh'hedu en la ilahe il-la Allah, ue esh'hedu en-ne muhammeden rasulullah.**

**(Dëshmoj se nuk ka Zot që meriton të adhurohet veç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij".**

A nuk ka ardhur koha vallë që të punosh për atë qëllim për të cilin je krijuar dhe të përqafosh të vërtetën e të pranosh ekzistencën e Krijuesit?

**HOTLINE**




**+971 56 204 2045**



**islamicicdx**



# CONTENTS



# Pyetje dhe Përgjigje rreth Islamit

ALBANIAN

(06/08)

الإسلام (سؤال وجواب)

FREE COPY

Pyetje të shpeshta bashkë me përgjigjet përkatëse






Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

المعرفة بالإسلام

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري  
Islamic Affairs & Charitable Activities Department

www.islamicic.com



# Çfarë është Islami dhe kush janë muslimanët?

Islami është mënyrë të jetuari gjithëpërfshirëse dhe e kompletuar, e nxit njeriun që të përmirësoj lidhjet e tij me Allahun dhe marrëdhëniet me njerëzit. Mësimet e Islamit tregojnë se njerëzit nuk gjejnë lumturi të vërtetë dhe paqe të përhershme veçse duke njohur Allahun, duke ndjekur udhëzimet e Tij dhe duke bërë vepra të mira të cilat i sjellin dobi individit si dhe rrethit shoqëror ku ai jeton.

Mesazhi i Islamit është shumë i qartë; Të besojmë se Allahu është Zoti dhe Krijuesi i gjithësisë, vetëm Atë të adhurojmë, mos ti bëjmë Atij shok në adhurim dhe të besojmë se Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është i Dërguar i Allahut dhe vula e Profetëve (Profeti i fundit).

Fjala "Islam" do të thotë bindje dhe nënshtrim ndaj Allahut. Pasuesit e fesë Islame quhen "muslimanë", pa marrë parasysh se çfarë përkatësie etnike apo raciale kanë.

## Cili është qëllimi i jetës?

Allahu nuk na ka krijuar që thjesht të sillemi rrotull pa kurrfarë qëllimi, nuk na ka krijuar që vetëm të përmbushim dëshirat dhe instiktet tona.

Ne jemi krijuar për një qëllim madhor; dhe ky qëllim është të njohim Allahun - Zotin e gjithësisë - dhe ta adhurojmë Atë, e të jetojmë sipas udhëzimeve të Tij dhe atëherë do të mund të kemi një jetë të suksesshme dhe harmoni të plotë në të gjitha aspektet, si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën.

*Prej urtësisë së Allahut është që i ka dhënë njeriut liri në zgjedhjen e tij, në mënyrë që të dallohet ai i cili i ndjek të Dërguarit e Allahut vullnetarisht e jo me detyrim, me dëshirë e jo me imponim, nga ai i cili nuk është i interesuar ti ndjek ata.*

Testimi i besimit të personit është që ai të përdor logjikën dhe intelektin e tij për të njohur argumentet e ekzistencës së Allahut dhe ti bindet Atij në atë çka Ai ka urdhëruar apo ndaluar.



## Kush është Allahu?

"Allah" është emri i veçantë i Zotit të vetëm;

- I cili meriton të adhurohet.
- I cili nuk ka ortak e as rival, nuk ka grua e as fëmijë.
- Atij i takojnë atributet më të larta.
- Ai është Krijuesi, e çdo gjë veç Tij është e krijuar. Mëshiruesi, Mëshirëbërësi, i Fuqishmi, Ngadhënjesi, i Drejti, i Gjithëdijsmi.
- Atij nuk i përngjason askush nga krijesat e Tij në atributet e të qënurit Zot dhe Krijuesi i gjithësisë, të cilit i takojnë të gjitha adhurimet.
- Vetëm Ai - e askush tjetër veç Tij - meriton të adhurohet.
- Vetëm Ai meriton ti thuhet: "O Allah".

## Kush është Muhamedi (paqja qoftë mbi të) ?

Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është Profeti i fundit i zinxhirit të gjatë të Dërguarve. Allahu e dërgoi atë te të gjithë njerëzit që ti thërras ata në adhurimin e Allahut, Zotit të vetëm.



Ai është shembulli më i përsosur për prindërit, bashkëshortët, mësuesit, drejtuesit, gjykatësit ... etj, i cili ka arritur gradën më të lartë në moral, drejtësi, besueshmëri, mëshirë, trimëri ...etj. Pavarësisht dashurisë dhe vlerësimit që muslimanët kanë për Profetin Muhamed (paqja qoftë mbi të), ata nuk e adhurojnë atë sikurse disa të tjerë adhurojnë Profetët e tyre.

## Përse besojmë në ekzistencën e Allahut

Argumentet që tregojnë për ekzistencën e Allahut janë të shumta; ato ndahen në dy lloje:

1- Argumente logjike të cilat bazohen në logjikën e thjeshtë dhe natyrën e pastër.

2- Argumente hyjnore të cilat i marrim vesh me anë të shpalljes së Allahut.

**Krijimi i botës** - Prej argumenteve të qarta që të shpien në besimin në ekzistencën e Allahut është hulumtimi në krijimin e botës. Si u krijua kjo botë?

Kjo botë e ka një fillim – për këtë bie dakort shumica e shkencëtarëve bashkëkohorë – dhe nuk është e mundur që të jetë krijuar nga hiçgjë, apo të ketë krijuar veten.

Shpjegimi më i arsyeshëm është që kjo botë, me gjithçka në të është e krijuar, kurse Allahu është Krijues dhe jo i krijuar.

Ai është i Pari pa fillim dhe i Fundit pa mbarim.

**Funksionimi i rregullt i universit.** Meditimi në mënyrën e funksionimit të kësaj bote është prej shkaqeve logjike që të çojnë në besimin e ekzistencës së Zotit, për arsye të mëposhtme:

1. Çdo gjë e sistemuar tregon doemos për një planifikim perfekt të mëparshëm.
2. Sistemi ynë diellor funksionon në varësi të disa ligjeve natyrore tepër të detajuara.
3. Atëherë, sistemi i kësaj bote tregon qartë për ekzistencën e të Gjithëdijshmit i cili ka vendosur rregullat e funksionimit të kësaj bote.

## Çfarë është Kur'ani

Kur'ani në vetvete është argument bindës mbi ekzistencën e Allahut për cilin do që kërkon të vërtetën sinqerisht. Ai është libër i veçantë në stilin, bukurinë, përmbajtjen dhe mësimet e tij. Ai është fjala e Allahut me të cilën sfidoi njerëzimin që të sjellin një të tillë, i cili ju zbrit Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) nëpërmjet melekut (ëngjëllit) Xhibril. Kur'ani është dëshmues për librat e mëparshëm (si psh: Teurati dhe Inxhili) dhe shfuqizues i disa prej dispozitave të tyre, ai është burimi bazë i sheriatit dhe shkencave islame.

*Kur'ani është fjala e Allahut dhe shpallja e Tij e fundit e zbritur për njerëzimin.*

Kur'ani trajton të gjitha çështjet primare të cilat lidhen me njeriun; si psh: qëllimi nga ardhja jonë në këtë botë, koncepti i ekzistencës së Zotit, veprat të cilat Ai i do dhe të cilat i urren, historitë e Profetëve të mëparshëm dhe mësimet që nxirren nga to, ndodhitë e Ditës së Gjykimit, Xhennetit dhe Zjarrit...etj.

Prej mrekullive të qarta të Kur'anit është ruajtja e tij nga shtrembërimi dhe deformimi, që nga koha që është zbritur e deri në Ditën e Gjykimit. Në të gjithashtu ka shumë fakte shkencore dhe ngjarje historike të cilat nuk kanë qenë të njohura për njerëzit gjatë kohës së zbritjes së Kur'anit, të cilat janë vërtetuar së fundmi, e këto janë vetëm disa prej argumenteve që vërtetojnë se Kur'ani është fjala e Allahut.



## Cilat janë kushtet e Islamit?

Shtylla e parë e Islamit është dëshmia e besimit; të besosh se Allahu është Zoti i Vetëm që meriton të adhurohet, dhe se Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është i Dërguari i fundit.

Shtylla e dytë: Falja e pesë namazeve gjatë ditës; namazi i sabahut, i drekës, i ikindisë, i akshamit dhe i jacisë.

Shtylla e tretë: Dhënia e Zekatit; dhe kjo kryhet duke nxjerrë një pjesë të caktuar nga pasuria (2.5%) – sipas disa kushteve të caktuara – pjesë kjo që u jepet të varfërve dhe nevojtarëve.

Shtylla e katërt: Agjërimi i muajit të Ramazanit; duke lënë ngrënien, pirjen dhe marrëdhëniet intime gjatë ditës, nga mëngjesi i hershëm e deri në perëndimin e diellit.

Agjërimi e ndihmon njeriun të përmbahet, të afrohet më shumë te Allahu si dhe i kujton atij kujdesjen ndaj të varfërve.

Shtylla e pestë: Kryerja e haxhit. Nëse muslimani ka mundësi fizike dhe ekonomike atëherë është obligim për të kryerja e haxhit të paktën një herë në jetë. Haxhi është simbol i unitetit të muslimanëve pa dallim ngjyre, race apo gjuhe. Në të mblidhen një mori ibadetesh dhe veprash të mira; si lutjet, kurbanit, shkuarja në Mekë, dhënia e lëmoshës dhe është vërtet një eksperiencë shpirtërore e veçantë.

## Cili është besimi i muslimanëve rreth Isait (Jezusi) dhe Profetëve të tjerë (paqja qoftë mbi ta)?

*Lindja e Isait (Jezusit) pa baba është një nga mrekullitë e Allahut, e Allahu i dha atij edhe mrekulli të tjera.*

Allahu ka dërguar mijëra profetë, në çdo popull ka patur një ose më shumë profetë, e të gjithë kanë ardhur me mesazhin e vetëm: "Adhuroni vetëm Allahun dhe mos i bëni Atij shok në adhurim". Prej këtyre Profetëve janë: Ademi, Nuhu, Ibrahim, Jakubi, Is'haku, Jusufi, Musai, Isai dhe Muhamedi (paqja dhe falja e Allahut qoftë mbi ta).

Isai (paqja qoftë mbi të) është një nga Profetët e mëdhenj e me vullnet të fortë të cilët Allahu i ka dërguar për të thirrur në rrugën e Tij.

Isai (paqja qoftë mbi të) nuk është Zot apo bir i Zotit dhe as nuk është pjesë e Trinitetit; e të gjitha këto kundërshtojnë konceptin e Zotit në Islam.

- Fragmente të shumta në Bibël tregojnë se Isai (Jezusi) vepron si një njeri i krijuar nga Allahu, dhe se Allahu është i veçuar me qënien e Tij nga krijesat (nuk është i përzier me ta); në këto fragmente tregohet se Isai falej dhe lutej e nëse do të ishte me të vërtetë Zot, kush do të ishte ai të cilin i falej dhe i lutej?!

- Termi "bir i Zotit" përdoret në formën simbolike në gjuhët e vjetra biblike dhe kihet me të qëllim "njeriu i mirë", sikurse është përmendur në shumë fragmente të Dhjatës së vjetër për disa nga Profetët dhe besimtarët e mirë të cilët kanë jetuar para Isait. Atëherë, ky term nuk është i veçantë vetëm për Isain (paqja qoftë mbi të). Gjithë problemi qëndron në përdorimin e fjalës "bir i Zotit" në kuptimin e vërtetë dhe jo në kuptimin figurativ.

Megjithëse muslimanët e duan dhe e respektojnë Isain (Jezusin) – sikurse dhe të gjithë Profetët e mëparshëm – ata nuk e adhurojnë atë, nuk e konsiderojnë atë si bir të Zotit dhe nuk i atribuojnë atij cilësitë e Allahut të cilat nuk i përkasin askujt veç Tij.



## A janë të gjitha fetë të ngjashme?

Vërejmë se shumica e feve bashkohen në të njëjtat parime të cilat lidhen me nxitjen për bamirësi, moral të mirë ...etj, ndërkohë feja Islame fokusohet krahas kësaj edhe te madhështia e Allahut, duke mos lejuar të çenohet në asnjë formë njësimi dhe përsosmëria e Tij. Ndryshe nga fetë e tjera, prej parimeve më primare në Islam është besimi se Allahu është ndryshe nga krijesat e Tij dhe askush nuk i përgjason Atij, dhe si pasojë në asnjë mënyrë nuk mund të krahasohen cilësitë e Tij me cilësitë e krijesave. Gjithashtu, të gjitha llojet e adhurimeve i takojnë vetëm Atij.

Islami është sistem jetese gjithëpërfshirës dhe i përsosur, i thjeshtë dhe shumë i zgjeruar, Libri i shenjtë – Kur'ani – dhe legjislacioni islam është i ruajtur në kujtesën e njerëzve sikurse është edhe i shkruajtur. Kur'ani nuk mohnon asnjë nga Profetët dhe të Dërguarit, ai vërteton se të gjithë ata janë dërguar nga Allahu me një mesazh të përbashkët: "Adhuroni Allahun e mos i bëni Atij shok në adhurim"

## Çfarë ndodh pas vdekjes?

Vdekja është porta e kalimit nga kjo botë e përkohshme për në botën e përhershme, çdo njeri do të ringjallet për të dhënë llogari për punët e tij Ditën e Gjykimit.

Atë ditë do të triumfojë drejtësia dhe secili do të marr atë që i takon. Çdokush i cili ka bërë ose i është bërë padrejtësi do të gjykohet me drejtësinë e Allahut, të Drejtit e të Gjithëdijshmit.

Ai i cili ka adhuruar vetëm Allahun e nuk ka adhuruar dikë tjetër bashkë me Të dhe ka bërë vepra të mira do të shpërblehet me hyrjen në Xhennet, falë mëshirës së Allahut.

Ndërsa ai i cili ka preferuar mosbesimin do të ndëshkohet duke hyrë në zjarrin e Xhehenemit.

Nëse nuk do të kishte një jetë tjetër në të cilën do tu shpërblente i miri për besimin e veprat e mira dhe do tu ndëshkonte i keqi për mosbesimin dhe padrejtësitë e tij; kjo do të binte në kundërshtim të plotë me drejtësinë absolute të Allahut dhe atëherë ekzistenca jonë në këtë botë do të ishte padrejtësi e madhe!




## Pozita e gruas në Islam

Në Islam mashkulli dhe femra janë të barabartë përsa i përket shpërblimit, thotë Allahu (subhanehu ue teala): "Kush bën vepër të mirë – qoftë mashkull apo femër – duke qenë besimtarë Ne do ti japim një jetë të mirë në këtë botë e në botën tjetër do ti japim shpërblimin më të mirë për veprat që kanë kryer". Kur'ani (16:97). E megjithatë, Allahu i ka caktuar secilit prej mashkullit dhe femrës role dhe përgjegjësi të ndryshme në varësi të diferencave fizike, psikike dhe mendore të tyre.

Islami e ka ngritur pozitën e femrës duke mos qënë e shtypur apo e parespektuar dhe i ka dhënë të drejtat e saj të cilat i janë mohuar në kohën para Islamit.

## A besojnë muslimanët në konceptin e "mëkatit fillestar"?

Në Islam nuk ekziston koncepti i quajtur "mëkati fillestar", sikurse besojnë disa prej të krishterëve se çdo njeri që lind ka pjesën e tij nga mëkati i Ademit. Allahu (subhanehu ue teala) është i Drejtë dhe nuk ndëshkon dikë për diçka që ai nuk e ka bërë e nuk është përgjegjës për të.



## Çfarë është Xhihadi?

Origjina e fjalës "xhihad" kthehet te sakrifica dhe përpjekja për shkak të fesë sipas mënyrës që Allahu dëshiron. Në aspektin gjuhësor fjala "xhihad" ka kuptimin e përpjekjes. Ajo përfshin përpjekjen dhe luftimin me veten për të kryer vepra të mira, për të shpenzuar pasurinë duke ndihmuar nevojtarët dhe luftën në rrugën e Allahut. Kuptimi më i përhapur i xhihadit është lufta në rrugën e Allahut, e cila u lejua fillimisht për të ruajtur ekzistencën e shoqërisë islame, për të ndaluar agresionin ndaj tyre, për të çuar në vend drejtësinë dhe për të ruajtur shtetin islam.

## A e përkrah Islami terrorizmin?

Shenjëstrimi i të pafajshmëve dhe atyre që nuk luftojnë gjatë luftës konsiderohet në Islam si vepër e ulët dhe e ndaluar. Madje, Islami ndalon shkuljen e pemëve dhe vrasjen e kafshëve pa shkak, e jo më vrasjen e njerëzve të pafajshëm.

Ky është një prej shembujve të shumtë nga të cilët dalin në pah parimet islame gjatë luftës. Megjithatë, duhet bërë dallim midis terrorizmit dhe rezistencës legjitime kundër pushtuesit, pasi që midis tyre ka ndryshim thelbësor.

## Çfarë është ushqimi hallall?

Ushqim hallall është çdo lloj ushqimi të cilin Allahu e ka lejuar të konsumohet. Në origjinë të gjitha ushqimet dhe pijet konsiderohen hallall (të lejuara), duke përjashtuar mishin e dërrit dhe alkoolin.

Gjithashtu, është obligim që kafsha të theret në mënyrë njerëzore dhe në formën e duhur, kjo përfshin përmendjen e emrit të Allahut para therjes dhe minimalizimin e vuajtjes së kafshës sipas mundësisë.

## Kush mund të bëhet musliman?

Allahu e ka lënë derën e Islamit të hapur për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh të shkuarën apo gjëndjen e tyre aktuale. E duke qënë kështu, çdo njeri ka mundësi të hyj në Islam në çdo kohë duke shqiptuar dhe besuar dëshminë e mëposhtme (dëshminë e besimit):

**Esh'hedu en la ilahe il-la Allah, ue esh'hedu en-ne Muhammeden rasulullah.**

**"Dëshmoj se nuk ka Zot që meriton të adhurohet veç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Tij".**

*Të qënurit musliman do të thotë të pranosh njëshmërinë dhe madhësitinë e Allahut, krijesit të gjithësisë, të përpiqesh të arrish kënaqësinë e Zotit duke ju bindur urdhërave të Tij e duke ju larguar ndalesave, e nëse i përmbahesh kësaj atëherë do të kesh jetë të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër.*

**HOTLINE**



**+971 56 204 2045**



**islamicicdx**



# CONTENTS



# KEQKUPTIME RRETH ISLAMIT

ALBANIAN

(07/08) مفاهيم خاطئة حول الإسلام

FREE COPY

Çfarë dini në të vërtetë rreth Islamit?






Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

لتعريف بالإسلام

دائرة الشؤون الإسلامية والعمل الخيري  
Islamic Affairs & Charitable Activities Department

www.islamicic.com



## HYRJE

Megjithëse Islami është një nga fetë më të përhapura në botë, ai është gjithashtu nga fetë më të keqkuptuara. Kjo ndodh për arsye të ndryshme; ndër to, është disinformimi që bëhet me anë të mediave për arsye politike, ekonomike, etnike dhe raciste, ose frika nga të pavërtetat që janë përhapur në lidhje me Islamin. Çelësi për të njohur Islamin e vërtetë është mos të biesh pre e koncepteve të gabuara dhe keqkuptimeve që lidhen me Islamin dhe gjykimi i çdo situatë duke u bazuar referencave të besueshme Islame.

Më poshtë përmendim disa nga keqkuptimet që lidhen me fenë Islame:

### 1 – “MUSLIMANËT NUK NDAJNË VLERA TË MIRA DHE FISNIKE ME JOMUSLIMANËT”

Disa njerëz pretendojnë se vlerat Islame janë të papërputhshme me vlerat europiane. Ky pretendim është shumë larg të vërtetës.

Islami nxit vlerat fisnike dhe universale si:

- Të jesh i drejtë dhe i ndershëm.
- Të mbash fjalën e dhënë.
- Të lejosh lirinë e besimit.
- Të respektosh prindërit, të afërmit, fqinjët, të moshuarit ..etj.
- Të jesh bamirës, bujar dhe të kujdesesh për të varfërit dhe nevojtarët.
- Të jesh i mirë me komshiun.
- Mos të gënjesh, mashtrosh, shash apo përgojosh askënd.

*Thotë Profeti (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të): “Më të mirët prej jush janë ata që kanë moralin më të mirë».*

Muslimanëve i kërkohet të japin kontributin e tyre në shoqëri dhe gjithmonë të sillen me veprimet më të mira dhe moralin më të lartë.



### 2 – “MUSLIMANËT ADHUROJNË NJË ZOT TË RI TË QUAJTUR ALLAH”

Fjala “Allah” në gjuhën arabe thuhet për Zotin e Gjithëfuqishëm. Ajo përmban kuptim të madh të cilën nuk e meriton vetëm se Allahu, një dhe i vetëm. Allah është gjithashtu e njëjta fjalë që arabfolësit krishterë dhe çifutë përdorin kur i referohen Zotit.

Megjithëse muslimanët, çifutët dhe të krishterët besojnë në të njëjtin Zot (Krijues), konceptet e tyre në lidhje me Të, janë shumë të ndryshme.

Muslimanët e refuzojnë idenë që Zoti ka partner ose është pjesë e një “triniteti” dhe ia atribuojnë përsosmërinë vetëm Zotit, të Plotfuqishmit.

*Muslimanët adhurojnë të njëjtin Zot që kanë adhuruar të gjithë Profetët e mëparshëm si Nuhu, Ibrahim, Musai dhe Isai ...etj.*



### 3 - “ISLAMI LEJON TERRORIZMIN”

Mediat zakonisht portretizojnë çdo musliman që lufton, si një terrorist, pa marrë parasysh nëse ai lufton me të drejtë apo jo, ose nëse ai është i shtypur apo agresor.

Islami e ndalon rreptësisht vrasjen e të pafajshmëve gjatë luftës, e jo më jashtë saj. Për më tepër, Islami ndalon vrasjen e kafshëve dhe shkatërrimin e bimëve pa nevojë, e jo më vrasjen e njerëzve të pafajshëm!

Është e nevojshme të bëjmë dallimin mes terrorizmit dhe rezistencës ndaj shtypjes, pasi që këto të dyja janë shumë të ndryshme nga njëra tjetra.

Kur’ani tregon qartësisht rrezikun e vrasjes së një personi të pafajshëm dhe e thekson vlerën e jetës njerëzore.

Thotë Allahu i Lartësuar:

«Kush vret ndokënd - që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë shkatërrime në Tokë - është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve».

(Kur’ani 5:32).

### 4 - “ISLAMI I SHTYP FEMRAT”

Në Islam, burri dhe gruaja janë të barabartë përpara Zotit, në aspektin e marrjes së shpërblimit të barabartë dhe llogaridhënies për veprimet e tyre. E vetmja gjë që i dallon njerëzit përpara Zotit është niveli i devotshmërisë.

«Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij».

(Kur’ani 49:13).

Ky varg provon që nderi i vërtetë dhe statusi nuk arrihet duke qenë një person i pasur apo i varfër, i bardhë apo i zi, mashkull apo femër, por arrihet me besim dhe devotshmëri.



Islami i ka dhënë gruas të gjitha të drejtat e saj dhe e ka nderuar atë. Gruaja është e barabartë me burrin atëherë kur barazia është e drejtë për të, si psh: në të drejtën e punësimit dhe ndjekjen e arsimit, në zgjedhjen e bashkëshortit..etj.

Fatkeqësisht, ka nga gratë muslimane që janë të shtypura dhe privohen nga të drejtat e tyre. Problemi në këtë rast, nuk është te Islami e as te mësimet dhe udhëzimet e tij. Problemi qëndron se disa njerëz ndjekin tradita dhe zakone të caktuara të cilat bien ndesh me fenë Islame e nuk kanë të bëjnë fare me të.

*Allahu, Krijuesi i të dy gjinive, ka caktuar role dhe përgjegjësi të ndryshme për secilin, duke marrë parasysh ndryshimet fizike dhe mendore që gjenden mes tyre dhe do ti kërkojë atyre llogari sipas përgjegjësive të secilit prej tyre.*

### 5 - “KUR’ANI ËSHTË THJESHT NJË LIBËR HISTORIE OSE POEZIE”

Kur’ani është fjala e Allahut, të Plotfuqishmit, i është zbritur Profetit Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të)



nëpërmjet ëngjëllit Xhibril. Ai është dallues dhe ndarës mes të kotës dhe të vërtetës, përmban udhëzim për njerëzit në mënyrë që ata të jetojnë të qetë e të lumtur.

Kur'ani përmban mësim nga gjeneratat e shkuara dhe tregime të Profetëve të mëparshëm në mënyrë që ne të përfitojmë nga historitë e tyre.

Ai na tregon për Allahun, Krijuesin tonë, si dhe për veten tonë. Gjithashtu ai përmend edhe qëllimin e ekzistencës sonë në këtë botë që është të njohim dhe të adhurojmë vetëm Allahun, Zotin e gjithësisë.

Allahu nuk i ka krijuar njerëzit që thjesht të vërdalisen pa kurrfarë qëllimi. Testi i besimit të njeriut është përdorimi i intelektit, vullnetit të lirë dhe aftësive të arsytimit për të menduar dhe për të njohur argumentet dhe mrekullitë e Zotit, një nga argumentet më të mëdha është Kur'ani.

Kur'ani në vetvete përmban mrekulli të shumta dhe ne nuk kemi asnjë dyshim që ai është i zbritur nga Allahu, Zoti i qiejve dhe tokës.

*Mënyra më e mirë që ta kuptosh se për çfarë flet dhe thërret Kur'ani, është ta lexosh vetë atë.*

## 6 - "MBULESA ËSHTË SHTYPJE"

Gratë muslimane janë të obliguara që të mbulohen e të mos e shfaqin trupin e tyre përpara burrave të cilët nuk i kanë të afërm. Megjithatë, mbulesa nuk është vetëm në paraqitjen e jashtme. Gratë muslimane janë të obliguara gjithashtu të kenë zemër të pastër nga zilia, mëndjemadhësia, ...etj, sikurse u kërkohet gjithashtu të zbukurohen me edukatën islame dhe sjelljen e mirë. Ndonëse mbulesa përmban në vetvete shumë të mira dhe dobi, arsyeja kryesore që gratë muslimane duhet ta marrin në konsideratë atë, është sepse ajo është detyrim nga Allahu i Lartësuar, dhe Ai e di se çfarë është më e mirë për njerëzit.



Mbulesa e fuqizon gruan duke e vënë theksin në bukurinë e saj shpirtërore, e jo në paraqitjen e saj të jashtme. Ajo i jep gruas lirinë e të qenurit anëtare aktive e shoqërisë duke ruajtur turpin dhe nderin e saj.

Mbulesa e femrës nuk simbolizon shtypje apo nënçmim. Përkundrazi, ajo është mbrojtëse nga shikimet epshore dhe diskriminimet e padrejta. Prandaj, nëse shikon nje grua muslimane, dije se ajo mbulon paraqitjen e saj të jashtme dhe jo mendjen apo intelektin e saj.

## 7 - "ISLAMI ËSHTË VETËM PËR ARABËT"

Vetëm rreth 20% e muslimanëve në botë janë arabë, që do të thotë se rreth 80% janë jo-arabë. Numri i muslimanëve në Indonezi dhe Indi është më i madh se numri i muslimanëve arabë. Islami na mëson se asnjë individ nuk është superior ndaj një tjetri për shkak të racës, ngjyrës apo kombësisë.

Islami ka një mesazh universal për gjithë njerëzimin: askush nuk mund të fitojë paqen dhe lumturinë veçse duke njohur dhe adhuroar Allahun, Zotin e Vetëm dhe duke ju përmbajtur udhëzimeve dhe urdhërave të Tij.



## 8 - “XHIHADI ËSHTË TERRORIZËM”

Esenca e xhihadit është që njeriu të luftojë dhe të sakrifikojë për fenë, në një mënyrë që e kënaq Zotin. Gjuhësisht «xhihad» do të thotë përpjekje dhe mund, dhe i referohet përpjekjes së njeriut për të bërë punë të mira dhe bamirësi. Xhihadi është përpjekje me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë ndaj vetvetes, epsheve, shejtanit dhe jo-besimtarëve. Forma më e njohur e luftës është ajo ushtarake që bëhet për të ruajtur mirëqënien e shoqërisë, të ndalojë shtypjen dhe të promovojë drejtësinë. Kjo mund të jetë defensive (mbrojtëse) ose ofensive (sulmuese), në varësi të rrethanave.

## 9 - “MUSLIMANËT ADHUROJNË MUHAMMEDIN OSE ZOTIN E HËNËS”

Keqkuptimi tjetër është që Muslimanët adhurojnë Profetin Muhammed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) Kjo është komplet e pavërtetë, dhe lehtësisht e hedhur poshtë nga fjala e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) : «Mos më lavdëroni mua (mos i kaloni kufijtë në lavdërim) ashtu si bënë të krishterët me Isain, të birin e Merjemit. Unë jam vetëm rob i Allahut, prandaj thoni ‘rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij’.»

Disa të tjerë pretendojnë se muslimanët adhurojnë hënën.

Ky pretendim është komplet i gabuar. Të adhurosh hënën, apo diçka tjetër përveç Allahut, është totalisht e ndaluar në Islam.

Adhurimet i takojnë vetëm Allahut, dhe dedikimi i adhurimit për dikë tjetër veç Tij është gjynahu më i madh.

Thotë Allahu i Lartësuar: «Ndër argumentet e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna. Mos bëni sexhde as për Diellin, as për Hënën, por, nëse jeni adhurues të Atij, bëni sexhde për Allahun, i Cili i ka krijuar ato!».

(Kur’ani 41:37).

Islami njih Perfeksionin e plotë, Madhësitinë dhe Njësimin e Allahut.




Ai është më i Drejti dhe më i Mëshirshmi.

Adhurimi dhe njësimi i Tij është esenca e fesë Islame, sikurse përmendet në Kur’an dhe në fjalët e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).

*Islami i mëson muslimanët të respektojnë e të duan të gjithë Profetët dhe të Dërguarit e Allahut. Por, respekti dhe dashuria jonë për ta nuk do të thotë që ti adhurujmë, pasi që adhurimi i takon vetëm Allahut.*

## 10 - “ISLAMI I LEJON MARTESAT E DETYRUARA”

Martesat i nënshtrohen një morie zakonesh dhe traditash të ndryshme sipas krahinave dhe popujve anembanë botës. Disa prej këtyre martesave bëhen pa dëshirën dhe aprovimin e gruas. Megjithëse kjo nuk ndodh vetëm te muslimanët. Martesat e



detyruara, i janë adresuar gabimisht ose me keqdashje Islamit.

Në Islam, si burrat edhe gratë kanë të drejtë të zgjedhin ose të refuzojnë një bashkëshort të mundshëm.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) ka lajmëruar se femra e rritur e cila është në moshë të dallojë ka të drejtën e zgjedhjes ose refuzimit të bashkëshortit.



## 11 - "ISLAMI I DETYRON NJERËZIT TË BËHEN MUSLIMANË"

Megjithëse është detyrim për muslimanët të përcjellin dhe shpërndajnë mesazhin e bukur të Islamit tek të tjerët, askush nuk detyrohet ta pranojë Islamit. Që të futet në Islam, një person duhet sinqerisht dhe vullnetarisht të besojë dhe ti bindet Zotit, kështu që, nuk mundet dikush të detyrohet që të pranojë Islamit.

Merr në konsideratë gjërat e mëposhtme:

Indonezia ka popullsinë më të madhe muslimane, e megjithatë Islami atje është përhapur pa u derdhur as edhe një pikë e vetme gjaku.

Në gadishullin arabik jetojnë mbi 14 milion të krishterë arab që prej 14 shekujsh më parë.

Islami është feja që po përhapet me ritmin më të lartë sot në botë.

Muslimanët sunduan gadishullin Iberik për 800 vite dhe nuk detyruan askënd që të linte fenë e tij dhe të hynte në Islam.

## PËRFUNDIM

Informimi rreth Islamit nga referenca të pakualifikuara dhe marrja e çfarëdo lloj lajmi që na serviret pa kurrëfar verifikimi, të shpie në keqkuptime dhe koncepte të gabuara rreth fesë Islame.

Mos bini pre të besoni çdo lloj informacioni që ju jepet për Islamit derisa të siguroheni që ai informacion është i vërtetë. Kjo fe të cilën e ndjek çereku i banorëve të Tokës nuk është ashtu sikurse mundohen ta përshkruajnë disa media botërore.

Islami është feja e paqes, mëshirës, humanizmit dhe drejtësisë.

A nuk meriton kjo fe të studiohet me kujdes përpara se të nxjerrim gjykimet tona për të?





+971 56 204 2045



islamicicdxb





# ATEIZMI

## SIPAS KËNDVËSHTRIMIT ISLAM

ALBANIAN

(08/08)

الإلحاد

FREE COPY





«Ne do t'u tregojmë atyre argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kurani) është i vërtetë».  
Kurani (41:53).



Your Path To Peace..

مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center  
للشؤون الإسلامية



**Kjo broshurë sqaron këndvështrimin Islam për besimin në Zot dhe shpjegon sesi Allahu sjell argumente që vërtetojnë ekzistencën e Tij, qofshin këto argumente logjike apo fetare. Kjo broshurë gjithashtu trajton dyshimet kryesore të ateistëve.**

Allahu i Lartësuar na ka ftuar që të besojmë nëpërmjet argumenteve që ka sjellë dhe na ka kërkuar të meditojmë në to, në mënyrë që të njohim ekzistencën e Zotit. Një pjesë e njerëzve besojnë në këto argumente, ndërsa një pjesë tjetër nuk besojnë dhe e konsiderojnë cdo gjë rastësore dhe pa qëllim. Allahu i ka krijuar njerëzit të prirë drejt besimit, veçse kjo prirje që gjendet te njeriu mund të forcohet e shtohet ose të dobësohet e të zbehet.

Është shumë e rëndësishme të kuptojmë se Allahu udhëzon atë që është i sinqert në kërkimin e të vërtetës dhe e humb atë që nuk është i interesuar të besojë.  
Thotë Allahu i madhëruar: "Allahu udhëzon në rrugën e vërtetë atë që kthehet te Ai". Kur'ani (13:27).

Kjo kërkon nga njeriu që nuk beson në ekzistencën e Allahut që të jetë objektiv dhe asnjëanës lidhur me ekzistencën e Tij dhe mos ta konsideroj atë si gjë të pamundur. Nëse personi nuk është në këtë pozitë nuk do mund të arrij kurrë te e vërteta edhe nëse ai është prej njerëzve më inteligjentë.

Është e rëndësishme të theksohet se për shkak të dallimeve rrënjësore mes Islamit dhe Krishterizmit në lidhje me konceptin e Zotit, shumë prej kritikave të cilat i drejtohen Krishterizmit nuk vlejné ndaj Islamit.



Allahu i Lartësuar na ka paralajmëruar ndaj atyre të cilët janë arrogantë dhe mendjemëdhenjë ndaj argumenteve të Tij, dhe na ka treguar se ata do të marrin ndëshkimin e merituar si pasojë e mosbesimit. Prandaj shpresojmë, që ata të cilët janë të sinqertë në kërkimin e të vërtetës, të përfitojnë nga këto informacione dhe detaje të cilat do t'u ndricojnë atyre rrugën e errët e do t'u hapin horizonte të cilat kanë qenë të mbyllura për ta më parë në lidhje me përfytyrimin e konceptit të Zotit, Krijuesit të gjithësisë.

## SHKAQET E BESIMIT TE ALLAHU

Më poshtë përmendim tre prej argumenteve llogjike të besimit në ekzistencën e Allahut, Zotit të vetëm:

### 1. Krijimi i botës

Argumenti i parë që tregon për ekzistencën e një Krijuesi lidhet me të kuptuarit e origjinës së universit. Imagjino sikur të jesh duke ecur në një shkretëtirë dhe papritur gjen në të një orë dore. Të gjithë e dimë që ora përbëhet prej xhamit, plastikës dhe metalit; xhami merret nga rëra, plastika nga përpunimi i naftës dhe metali nxirret nga thellësitë e tokës; e të treja këto gjenden në shkretëtirë. Atëherë, a mendon se kjo orë



*"A mos janë krijuar nga asgjë, apo ata vetë janë krijuar?" (Kur'ani 52:*

është krijuar vetë? A mendon që një ditë lindi dielli, fryu era e doli nafta në sipërfaqe të tokës duke u përzier me rërën dhe metalin, e për miliona viteve u formua kjo orë rastësisht, për shkak të koicidencës natyrore? Sipas shkencës moderne kjo botë e ka një fund, sikurse ka edhe një fillim.

Atëherë; prej nga erdhi kjo botë? Përvoja dhe logjika e thjeshtë tregojnë se çdo gjë ka një fillim e nuk vjen nga asgjë, e gjithashtu nuk mund të vetëkrijohet. Prandaj, shpjegimi më i arsyeshëm është që ekziston një Krijues i cili ka krijuar universin. Krijues i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm, që krijoi këtë botë dhe vendosi në të "rregulla natyrore" të cilat e sundojnë. E duke qenë kështu; atëherë besojmë që ky Krijues nuk i nënshtrohet rregullave të vendit dhe kohës për shkak se vendi dhe koha janë të krijuara dhe kanë një fillim.

E të gjitha cilësitë e sipërpërmendura përbëjnë konceptin e ekzistencës së Krijuesit të universit, Allahut. Dikush mund të pyesë : "Kush e ka krijuar Allahun"? Allahu është Krijuesi i gjithësisë dhe ndryshon nga krijesat. Ai është i Përhershëm, ka qenë i tillë gjithmonë dhe nuk ka fillim, prandaj pyetja se kush e ka krijuar Atë është jashtë çdo koncepti logjik.

Dikush mund të pyesë : "Kush e ka krijuar Allahun"? Allahu është Krijuesi i gjithësisë dhe ndryshon nga krijesat. Ai është i Përhershëm, ka qenë i tillë gjithmonë dhe nuk ka fillim, prandaj pyetja se kush e ka krijuar Atë është jashtë çdo koncepti logjik.

## 2. Krijimi perfekt i universit

Argumenti i dytë i cili tregon për ekzistencën e një Krijuesi është rregulli dhe balancimi perfekt i cili gjendet në këtë botë të komplikuar. A mundet ky univers i komplikuar të jetë krijuar rastësisht, pa ndërhyrjen e të Plotëfuqishmit, të Gjithëdijshtëmit?

Shumë prej vecorive dhe tipareve të kësaj bote tregojnë qartë se janë të dizenuara vecanërisht për mbarëvajtjen e jetës në këtë botë, si psh: distanca e Tokës nga Dielli, trashësia e bërthamës së Tokës, shpejtësia e rrotullimit të Tokës, përçindja e oksigjenit në atmosferë, grada e pjerrësisë së Tokës ....etj.






Nëse këto përmasa do të ndryshonin qoftë edhe pak, nuk do të ishte e mundur jeta në Tokë.

E duke pasur parasysh që ora e dorës ka një krijues i cili ka ditur se si ta regjistrojë kohën saktësisht; atëherë edhe Toka në të cilën jetojmë ka doemos një Krijues i cili e di shumë mirë kohën kur ajo rrotullohet rreth diellit.

A mundet që e gjithë kjo të ndodhë vetvetiu? Kur shohim gjithë këto rregulla dhe ligje natyrore perfekte në veten tonë dhe kudo në botë; A nuk është e logjikshme që dikush e ka mirëorganizuar gjithë këtë?

Shpjegimi më i saktë në lidhje me këtë organizues kaq perfekt është ekzistenca e Allahut, i vetmi i cili ka krijuar gjithçka.

Vlen të theksohet se Islami i nxit kërkimet shkencore dhe e inkurajon njeriun që të meditojë. Shkenca na ndihmon në përshkrimin e shumë rregullave natyrore të cilat Allahu i ka vendosur në këtë botë, si dhe në njohjen e fuqisë dhe urtësisë së Allahut. Avancimet shkencore, sikurse çdo mekanizëm i ri apo proces natyror që zbulohet si psh: forca e gravitetit, cikli i ujit... etj, janë prova për ekzistencën e një Organizuesi dhe Dizenjuesi, jo argumenta kundër Tij.



### 3. Shpallja e Allahut

Argumenti i tretë është shpallja, të cilën Ai ja dërgoi njerëzimit si argument tregues për ekzistencën e Tij.

Prej synimeve kryesore të Kur'anit është thirrja e njerëzve që të meditojnë në krijimin e Allahut si rrugë paraprirëse për në besim. Në ajetet kur'anore Allahu na nxit që të meditojmë në krijimin e Tij madhështor në univers dhe në vetet tona, të cilat janë argumente të mjaftueshme që tregojnë se gjithçka është krijim i Zotit të Gjithëdijshëm.

Thotë Allahu i Lartësuar:

*“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t'u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë lloj-lloj gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit që llogjikojnë”. Kur’ani (2:164).*



E për më tepër, në Kur’an gjenden argumente të qarta që tregojnë se Kur’ani është fjala e Allahut, përmendim disa prej tyre:

#### Kur’ani famëlatë:

- Nuk ka në të gabime e as kundërshtime.
- Kur’ani është ruajtur fjalë për fjalë ashtu sikurse ka zbritur në gjuhën e tij origjinale -në gjuhën arabe-, ndryshe nga librat e tjerë të zbritur.
- Mesazhi i Kur’anit është i qartë dhe i thjeshtë, lë ndikim në logjikën e njeriut si dhe në idetë që njeriu i ka në lidhje me Allahun.
- Kur’ani ka zbritur prej më shumë se 1400 vitesh, e megjithatë shumë fakte shkencore të panjohura për njerëzit në atë kohë janë zbuluar vetëm së fundmi nga shkenctarët. E prej këtyre fakteve është: Uji është origjina e çdo qenie te gjallë. (Kur’ani 21:30). Zgjerimi i universit. (Kur’ani 51:47). Dielli dhe hëna, secili prej tyre ka orbitën përkatëse në të cilën noton. (Kur’ani 21:33).
- Kur’ani përmban shumë fakte historike të cilat nuk kanë qenë të njohura nga njerëzit në atë kohë, për më tepër në Kur’an ka parashikime për disa ndodhi, saktësia e të cilave është vërtetuar më vonë.
- Kur’ani i është zbritur të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (paqja qoftë mbi të) i cili ka qenë analfabet, e megjithatë ai përmban një mënyrë të shprehuri tepër unike dhe njihet botërisht si grada më e lartë e elokuencës dhe bukurisë gjuhësore arabe.
- Shpjegimi më i arsyeshëm i vecorive dhe mrekullive të cilat gjenden në Kur’an është që, ai mund të jetë vetëm nga Allahu.

*Kur’ani është memorizuar (mësuar përmendësh) i gjithi nga miliona muslimanë.*

*Kur’ani lë ndikim të thellë te njeriu, nuk e ndjen atë, veçse ai i cili e ka shijuar me zemër ëmbëlsinë e Kur’anit.*



## PYETJE RRETH ALLAHUT

### Përse Allahu na ka krijuar?

Të gjithë jemi koshientë që çdo pjesë e trupit të njeriut si sytë, veshët, truri, zemra ..etj, ekzistenca e tyre është për një qëllim të caktuar.

A nuk tregon kjo që edhe ekzistenca e çdo individ - si i plotë - ka një qëllim të caktuar gjithashtu?

Allahu nuk na ka krijuar që thjesht të sillemi rrotull pa kurrfarë qëllimi, ose që vetëm të përmbushim dëshirat dhe instiktet tona. Ne jemi krijuar për një qëllim madhor; dhe ky qëllim është të njohim Allahun - Zotin e gjithësisë - dhe të adhurojmë vetëm Atë. Kjo botë nuk është veçse një testim ku secili do të testohet në besimin e tij te Allahu dhe ndjekjen e urdhërave të Tij.

Thotë Allahu i Lartësuar:

“Ne e krijuam njeriun nga një pikë fare e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë e të shohë.

Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës”. Kur’ani (76:2-3).

Cështja primare për shumë njerëz, nuk është besimi te Allahu, por pasojat që lidhen me besimin. Kjo do të thotë që çdo person do të llogaritet për veprat e tij, gjë e cila mund të mos ti pëlqejë disave apo ti përshtatet mënyrës së tyre të jetesës. Për këtë shkak testimi i njeriut në këtë botë përfshin ndjekjen e udhëzimit të Allahut dhe nënshtrimin ndaj Tij karshi dëshirave dhe egrove tona personale.

### A ka Allahu nevojë që të na sprovojë?

Allahu i Lartësuar nuk ka nevojë për asgjë; Ai nuk ka nevojë të krijojë apo sprovojë askënd.

Allahut nuk i sjell dobi besimi jonë, e as i bën dëm mosbesimi jonë. Prej urtësisë së Allahut është që na ka krijuar dhe na ka dhënë mundësinë që ne ta njohim dhe ta adhurojmë Atë, megjithëse Ai di gjithçka që do të ndodhë. Prandaj rëndësi ka puna dhe testimi jonë, e jo a ka Allahu nevojë të na sprovojë apo jo.

### A e kemi, në të vërtetë, zgjedhjen në dorë?

Fakti që Allahu i Lartësuar di zgjedhjet tona nuk do të thotë që ne nuk kemi liri të zgjedhim atë që dëshirojmë. Megjithëse Allahu do që njerëzit të besojnë, Ai nuk detyron askënd, e nëse do të dëshironte do ti udhëzonte të gjithë njerëzit, sepse Ai është i Fuqishëm të bëjë gjithçka. Prej urtësisë së Allahut është krijimi jonë, dhënia e të drejtës së zgjedhjes dhe marrja në llogari për to, e kjo nuk do të thotë demos që Ai kënaqet me atë që ka lejuar të ndodhë.

### Përse nuk mundemi ta shohim Allahun?

Allahu i Lartësuar me urtësinë e Tij ka vendosur që ne ta njohim atë me anë të mrekullive dhe veprave të Tij, dhe kjo është pjesë e testimit tonë në këtë botë.

Ai na ka dhënë përgjegjësinë e zgjedhjes mes të mirës dhe të keqes dhe përdorimin e aftësive tona në besim. Kjo do të thotë, se vetëm ata të cilët e kërkojnë udhëzimin sinqerisht dhe meditojnë në krijimin e qiejve dhe tokës, do ta njohin dhe besojnë në Të.



## Përse ekziston e keqja në këtë botë?

Fakti që njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe që mënyrat e sprovimit të tyre ndryshojnë nuk do të thotë që Allahu nuk ekziston ose që kjo bie ndesh me fuqinë e Tij absolute.

E mira dhe e keqja përbëjnë testimin dhe sprovimin tonë në këtë botë. Ne nuk mund të kontrollojmë apo të dimë çfarë do të na ndodhë në të ardhmen, por mund të kontrollojmë reagimet dhe kundërveprimet tona ndaj asaj që na ndodh. Dhe për këtë do të merremi në llogari. Bota në të cilën jetojmë është e paqëndrueshme dhe e përkohshme, ndërsa bota tjetër është konstante dhe e përhershme, e në të do të shpërblehet çdokush për atë që ka vepruar e do të marr atë që i takon.

## “Përse Zoti i ndëshkon njerëzit?”

Askush nuk mund ta kundërshtoj konceptin e ndëshkimit, i cili është i domosdoshëm për vendosjen e drejtësisë. Allahu na ka dhënë të drejtën e zgjedhjes, e sipas asaj që ne zgjedhim, do të gjykohe mi.

Ata, të cilët janë të sinqertë në bindjen ndaj Allahut, Ai do ti përfshijë në mëshirën e Tij dhe do t'i fus në Xhenet. Ndërsa ata, të cilët nuk i kushtojnë rëndësi qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mohojnë ekzistencën e Zotit, të tillët e kanë zgjedhur rrugën e tyre, e do të japin llogari për zgjedhjen e bërë. Allahu i Lartësuar nuk i ka krijuar njerëzit për ti dënuar, përkundrazi Ai dëshiron që të jua lehtësoj atyre punët e t'i udhëzojë ata në kryerjen e veprave të mira. Fakti që Allahu i di zgjedhjet që ne do të bëjmë, nuk nënkupton që Ai na ka detyruar, e as na shpëton neve nga dhënia llogari.

Islami është fe praktike, e inkurajon njeriun që të balancojë mes shpresës të Allahut dhe frikës nga ndëshkimimi i Tij, e të dyja këto janë të domosdoshme për të jetuar një jetë pozitive. Allahu është Mëshirëbërës, gjithashtu Ai është edhe Gjykuesi më i drejtë, e nëse nuk do të kishte botë tjetër pas vdekjes; kjo do të kundërshtonte drejtësinë absolute të Allahut dhe jeta jonë do të ishte e padrejtë.

## Përfundim

A jetojmë në këtë botë 80 vite apo diçka të tillë dhe më pas përfundon gjithcka?

Apo do të ketë një jetë tjetër?

A jemi ne vallë, thjesht majmuna të evoluar pa një qëllim të lartë? A jemi ne vallë qenie materiale vetëm me nevoja fizike? Apo kemi gjithashtu nevoja shpirtërore?

Këshilla jonë për ata të cilët kërkojnë të vërtetën lidhur me ekzistencën e Zotit dhe akoma nuk kanë arritur në një përfundim është që të lutem me sinqeritet duke thënë:

“ O Allah, nëse Ti ekziston, më udhëzo.” Dhe do të befasohesh me rezultatin.

**HOTLINE**

**+971 56 204 2045**



**islamicicdx**





مركز المعلومات الإسلامي  
Islamic Information Center

لتعريف بالإسلام

Part of the



# ISLAMIC e-LIBRARY

Learn more about Islam with our informative and educational materials, translated to over 50+ languages



Quran



Flyers



Books

[iicdxb.com/flyers](http://iicdxb.com/flyers)

@islamicicdxb

